



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Infermieri” me profile “Infermieristikë në Pediatri”,
“Infermieristikë në Kirurgji”, “Infermieristikë në Kujdesin
Intensiv”, “Infermieristikë në Urgjencë”, “Infermieristikë në
Obsetrikë dhe Gjinekologji”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Western Balkan University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli

2. Prof. Asoc. Fatjona Kamberi

Shtator/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile “Infermieristikë në Pediatri”, “Infermieristikë në Kirurgji”, “Infermieristikë në Kujdesin Intensiv”, “Infermieristikë në Urgjencë”, “Infermieristikë në Obsetrikë dhe Gjinekologji” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Western Balkan University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Western Balkan University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Masteri i Shkencave në “Infermieri” me profile “Infermieristikë në Pediatri”, “Infermieristikë në Kirurgji”, “Infermieristikë në Kujdesin Intensiv”, “Infermieristikë në Urgjencë”, “Infermieristikë në Obsetrikë dhe Gjinekologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 586, datë 04.10.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/5 PAK v.a. 2023-2024 10 PAE/10 PAK v.a. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	- 10 Studentë (6 në gjuhën shqipe+4 në gjuhën angleze) v.a. 2023-2024 - 5 Studentë në gjuhën angleze v.a. 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

WB është krijuar me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021, "Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Universiteti Western Balkans". WBU është një Institucion i rid he në process akreditimi. Gjatë periudhës së vizitës u informuam se është përfunduar dhe vizita nga ekspertët dhe pritët vendimi i Bordit të Akreditimit. Western Balkan University ka në përbërjen e vet tre (3) Njësi Kryesore dhe tetë (8) Njësi Bazë nga të cilat tre (3) janë Qendra Kërkimore.

Njësitë Kryesore të Universitetit Western Balkan janë:

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
- Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Master Shkencave në "Infermieri", ka në përbërjen e vet:

- Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti i Mjekësisë;
- Departamenti i Kirurgjisë;
- Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë;
- Qendra Kërkimore-Shkencore SSR.

WB është krijuar me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021, "Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Universiteti Western Balkans". Programi i studimit është hapur me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 586, datë 04.10.2022. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike ka në përbërjen e vet 9 anëtarë me kohë të plotë. Dy prej këtyre ka titullin professor i asociuar, dy mbajnë gradën shkencore Dr., ndërsa pjesa tjetër e Njësisë Bazë ka Master Shkencor. Njësia Bazë ka dhe 5 staf akademik PAK, 1 prof. Dr., 1 Dr., dhe tre me MSc. Dy staf ndihmës akademik janë pjesë e Njësisë Bazë. Për ofrimin e këtij programi studimi përfshihen nëntë staf akademik PAE (2 prof. Asoc., 2 Dr., dhe pesë MSc) dhe 10 staf akademik PAK (3 Dr. dhe shtatë MSc.). Institucioni në funksion të programit të studimit ka ngritur laboratore, përfshirë këtu laboratorin e Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore. Infrastruktura e Institucionit është e përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit *Master i Shkencave në "Infermieri"*, me profile "Infermieristikë në Pediatri", "Infermieristikë në Kirurgji", "Infermieristikë në Kujdesin Intensiv", "Infermieristikë në Urgjencë", "Infermieristikë në Obsetrikë dhe Gjinekologji", të ofruar nga Universiteti "Western Balkans", filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga WBU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 14-15 Maj 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje Prof. Asoc. Fatjona Kamberi dhe Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, ditën e parë u zhvillua dhe vizita në sekretarinë mësimore. Ditën e dytë GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Zyrës së Kërkimit Shkencor, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, përfaqësues të Zyrës së Planifikimi të Karrierës dhe përfaqësues të Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatorin Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Me datë 15.07.2024 GVJ dergojë draft RVJ-në në IAL nëpërmjet sistemit AMS. Me datë 22.07.2024, IAL shpreh mendimet e saj rreth përmbajtjes së raportit, të cilat janë analizuar nga GVJ dhe shprehen si më poshtë vijon:

Përgjigje Komenti 1: GVJ ka konstatuar se Institucioni nuk ka staf infermieror me tituj dhe grada. Kjo është përmendur, sepse, siç është e parashikuar në legjislacionin në fuqi, për të dhënë leksion në një cikël studimesh duhet të kesh përfunduar një cikël më të lart studimesh. Duke patur parasysh që ky është një Master Shkencor dhe stafi akademik që zhvillon leksionet duhet të ketë të paktën titullin Dr. Një pjesë e stafit nuk e ka këtë titull dhe GVJ sugjeron që të rriten përpjekjet për

promovimin e stafit akademik. GVJ ka raportuar që WBU ka një staf me eksperiencë në mësimdhënie dhe kjo është një pikë e fortë.

Përgjigje Komenti 2: GVJ ka evidentuar në draft raport të gjitha evidencat që Institucioni ka. Pavarësisht funksionimit të tij për një kohë të shkurtër, WBU ka rregullore të cilat përcaktojnë funksionimin e institucionit. GVJ konsideron të rëndësishme Rregulloren e Njesisë Bazë dhe është shumë pozitive që është miratuar sipas asaj që raportohet në komentin tuaj. Implementimi i një nga rekomandimeve të GVJ në kohë kaq të shkurtër është shumë pozitive dhe një tregues i qartë i punës së mirë të Institucionit. Duke patur parasysh që GVJ vlerëson deri në periudhën e zhvillimit të vizitës në IAL (14/15-05-2024), përmbushja e kësaj pike do të vlerësohet në akreditimin e rradhës.

Përgjigje Komenti 3: GVJ e vlerëson përgjigjen e institucionit për këtë pikë. Përfshirja e ekspertëve profesionistë të fushës është shumë pozitive dhe GVJ e inkurajon këtë. GVJ është në dijeni që ky është një program i ri dhe hartimi dhe implementimi i analizave të vazhdueshme ka nevojë për një kohë të caktuar.

Përgjigje Komenti 4: Mobiliteti i studentëve në IAL jashtë Shqipërisë është diçka që Institucioni duhet të punoj më shumë. GVJ e vlerëson dhe e konsideron shumë pozitive mobilitetin e dy studentëve në periudhën 17-21 Qershor në Universitetin e Chiet-it. Duke patur parasysh që GVJ vlerëson deri në periudhën e zhvillimit të vizitës në IAL (14/15-05-2024), përmbushja e kësaj pike do të vlerësohet në akreditimin e rradhës. Vendimi i mobilitetit të studentëve është marrë në datën 28.05.2024 pas vizitës së GVJ në Institucion. Pavarësisht kësaj, fillimi i mobiliteteve konsiderohet si shumë pozitive nga GVJ. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera me IAL dhe institucione jashtë Shqipërisë. Kjo është konfirmuar dhe në raport.

Përgjigje Komenti 5:

Hartimi i rregullt i një analize mbi rezultatet e marrëveshjeve, është diçka që GVJ e konsideron të rëndësishme. GVJ konsideron pozitive komunikimin e rregullt midis Njesisë Bazë dhe Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë.

Përgjigje Komenti 6:

Shiko përgjigjen në Komentin 2.

Përgjigje Komenti 7:

GVJ sugjeron rritjen e orëve laboratorike si dhe ndryshimin e krediteve të lëndëve. Përfshirja e ekspertëve profesionistë të fushës është shumë pozitive dhe GVJ e inkurajon këtë.

Përgjigje Komenti 8:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 9:



GVJ e vlerëson përgjigjen e institucionit për këtë pikë. Përfshirja e ekspertëve profesionistë të fushës është shumë pozitive dhe GVJ e inkurajon këtë. GVJ është në dijeni që ky është një program i ri dhe procedura për përmirësimin e programit nuk ka filluar ende.

Përgjigje Komenti 10:

GVJ sugjeron rritjen e orëve laboratorike si dhe ndryshimin e krediteve të lëndëve. Përfshirja e ekspertëve profesionistë të fushës është shumë pozitive dhe GVJ e inkurajon këtë.

Përgjigje Komenti 11:

GVJ sygjeron rritjen e orëve laboratorike si dhe ndryshimin e krediteve të lëndëve. Përfshirja e ekspertëve profesionistë të fushës është shumë pozitive dhe GVJ e inkurajon këtë.

Përgjigje Komenti 12:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 13:

Mobiliteti i studentëve në IAL jashtë Shqipërisë është diçka që Institucioni duhet të punoj më shumë. GVJ e vlerëson dhe e konsideron shumë pozitive mobilitetin e dy studentëve në periudhën 17-21 Qershor në Universitetin e Chiet-it. Duke patur parasysh që GVJ vlerëson deri në periudhën e zhvillimit të vizitës në IAL (14/15-05-2024), përmbushja e kësaj pike do të vlerësohen në akreditimin e rradhës. Vendimi i mobilitetit të studentëve është marrë në datën 28.05.2024 pas vizitës së GVJ në Institucion. Pavarësisht kësaj, fillimi i mobiliteteve konsiderohet si shumë positive nga GVJ. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera me IAL dhe institucione jashtë Shqipërisë. Kjo është konfirmuar dhe në raport.

Përgjigje Komenti 14:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 15:

GVJ ka konstatuar mbështetjen financiare të stafit akademik nga Institucioni. Funkcionimi i WBU për një kohë të shkurtër është e kuptueshme nga GVJ dhe kjo është raportuar dhe në raportin e dorëzuar.

Përgjigje Komenti 16:

Ju faleminderit për përgjigjen. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për projekte kërkimore dhe inkurajon ngritjen e grupeve kërkimore.

Përgjigje Komenti 17:

Ju faleminderit për përgjigjen. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për projekte kërkimore dhe inkurajon publikimin në revista prestigjioze me faktor impakti.

Përgjigje Komenti 18:



Ju faleminderit për përgjigjen. GVJ inkurajon Institucionin të nënshkruaj marrëveshje me “Urdhrin e Infermierit”.

Përgjigje Komenti 19:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 20:

Mobiliteti i studentëve në IAL jashtë Shqipërisë është diçka që Institucioni duhet të punoj më shumë. GVJ e vlerëson dhe e konsideron shumë positive mobilitetin e dy studentëve në periudhën 17-21 Qershor në Universitetin e Chiet-it. Duke patur parasysh që GVJ vlerëson deri në periudhën e zhvillimit të vizitës në IAL (14/15-05-2024), përmbushja e kësaj pike do të vlerësohen në akreditimin e rradhës. Vendimi i mobilitetit të studentëve është marrë në datën 28.05.2024 pas vizitës së GVJ në Institucion. Pavarësisht kësaj, fillimi i mobiliteteve konsiderohet si shumë pozitive nga GVJ. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera me IAL dhe institucione jashtë Shqipërisë. Kjo është konfirmuar dhe në raport.

Përgjigje Komenti 21:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 22:

Ju faleminderit për përgjigjen. GVJ sugjeron që të rriten përpjekjet për promovimin e stafit akademik.

Përgjigje Komenti 23:

Ju faleminderit për përgjigjen.

Përgjigje Komenti 24:

Ju faleminderit për përgjigjen. GVJ inkurajon pasurimin e vazhdueshëm të literaturës.

Përgjigje Komenti 25:

Ju faleminderit për përgjigjen.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri” me profile “Infermieristikë në Pediatri”, “Infermieristikë në Kirurgji”, “Infermieristikë në Kujdesin Intensiv”, “Infermieristikë në Urgjencë”, “Infermieristikë në Obsetrikë dhe Gjinekologji”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Western Balkans (WB) organizohet dhe funksionon si Universitet privat me karakter akademik dhe shkencor, i cili ofron programe të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë. Universiteti WB është themeluar me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 679, datë 10.01.2021, "Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Universiteti Western Balkans". Universiteti Western Balkans është person juridik, i ndarë nga ai i themeluesit dhe laik. Institucioni vepron në bazë të Kushtetutës, të Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë si dhe në bazë të legjislacionit Shqiptar.</p> <p>Evidenca:</p> <p>- <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e WB. Nenet 3-5 të Statutit të WB përcaktojnë qartë misionin dhe objektivat e Institucionit. Misioni i Universitetit Western Balkans është formimi i profesionistëve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë, si edhe angazhimi për të qënë një universitet i spikatur ndërkombëtarisht në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllimin kryesor të pëmirësimit të vazhdueshëm të jetës. Objektivat kryesore fokusohen në kërkim, në mësimdhënie dhe kontribut për shoqërinë. Universiteti Western Balkans glzon autonomi financiare, organizative dhe te perzgjedhjes se personelit. Institucioni ka përcaktuar 10 fusha strategjike të cilat fokusohet të implementoj. Çdo fushë strategjike ka të përcaktuara qartë qëllimet, objektivat dhe aktivitetet.</p>

	<p>Sipas Planit Strategjik të IAL-së, WB ka si vizion të ketë një ndikim pozitiv në shoqëri dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve përmes ekselencës dhe inovacionit të vazhdueshëm në kërkimin shkencor, arsimin, kujdesin shëndetësor, kreativitetin dhe sipërmarrjen.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve të Infermierisë në profilet përkatëse. Masteri i Shkencave në “Infermieri” me profile synon të formojë të diplomuarit në profilet përkatëse si ekspertë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e përkujdesjes infermiore dhe sigurinë e pacientit.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL-së. Rregullorja e Programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me fushat dhe drejtimet e Institucionit si dhe në bazë të akteve dhe vendimeve të brendshme të tij. Sipas planit strategjik, misioni i WB është formimi i profesionistëve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë, si edhe angazhimi për të qënë një universitet i spikatur ndëkombëtarisht në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllimin kryesor të pëmirësimit të vazhdueshëm të jetës. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe në bazë të Statutit, Rregullores dhe Planit Strategjik të Institucionit. Dy nga tre Njësitë Kryesore të Institucionit e fokusojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shëndetësisë dhe ky program studimi përputhet totalisht me një nga fushat kryesore akademike të Institucionit.</p>




	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030. 			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Universiteti synon arritjen e kapaciteteve të përthithjes së studentëve dhe stafit akademik përtej kufinjve vendas, në mënyre që teksa edukon, të pasurojë eksperiencat e studentëve dhe stafit vendas. Programi i studimit është hartuar në bazë të lgjislacionit vendas si dhe në bazë të prioriteteve strategjike të vendit. Për hartimin e programit është marrë parasysh Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë si dhe Strategjia kombëtare e Kërkimit Shkencor. Në terma afatgjatë, WBU udhëhiqet nga parimet e një Universiteti të Gjeneratës së 4-të që kërkon të përmbushë kërkesat e revolucionit të katërt industrial (4IR). WBU synon të zhvillohet në një universitet të bazuar në kërkime dhe në këtë mënyrë të ndjekë tetë karakteristikat e një Modeli Global në zhvillim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti Western Balkans organizohet dhe funksionon si Universitet privat me karakter akademik dhe shkencor, i cili ofron programe të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë. Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e WB. Nenet 3-5 të Statutit të WB përcaktojnë qartë misionin dhe objektivat e Institucionit. Masteri i Shkencave në "Infermieri" synon të formojë të diplomuarit në profilet përkatëse si ekspertë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e përkujdesjes infermierore dhe sigurinë e pacientit. Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me fushat dhe drejtimit e Institucionit si dhe në bazë të akteve dhe vendimeve të brendshme të tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.****Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

WB është krijuar me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021, "Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Universiteti Western Balkans". Programi i studimit është hapur me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 586, datë 04.10.2022. Per vitin 2023-2024, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike ka në përbërjen e vet 9 anëtarë me kohë të plotë (PAE) që janë angazhuar në këtë program studimi (1 Prof. Asc., 1 Dr, 4 Msc dhe 2 Bsc). Gjithashtu ka dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), (1 prof. Dr., 1 Dr., 3 MSc.) Institucioni në funksion të programit të studimit ka ngritur laboratore, përfshirë këtu laboratorin e Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore. Infrastruktura e Institucionit është e përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi. *GVJ konsideron se edhe pse institucioni është relativisht i ri në funksionim, disponon infrastrukturën e përshtatshme për ofrimin e programit të studimit. Ndërkohë që stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie ka kapacitete potenciale dhe eksperiencë të nevojshme. Angazhimi i stafit akademik infermieror me tituj shkencor dhe grada akademike në mesin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit duhet të jetë një nga prioritetet në vazhdim të institucionit.*

Evidenca:

- Evidenca 1.5 Tabela 6. Stafit Akademik për programin Masteri Shkencave në Infermieri;
- Evidenca 1.6 Lista e laboratoreve të FSHMT;
- Evidenca 2.10 VKM për hapjen e WBU;
- Evidenca 2.11 Urdhri i hapjes së programit MSc në Infermieri me 5 profile;
- Evidenca 2.14 Tabela 1 Numri i personelit akademik;
- Evidenca 4.8-Relacion mbi infrastrukturën në WBU.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e

Fusha e përgjithshme si dhe fusha specifike e programit të studimit Masteri i Shkencave në "Infermieri" është në përputhje me fushën akademike të Njësive Kryesore dhe Bazë që ofrojnë këtë program studimi. Njësia Kryesore (Fakulteti i Shkencave Mjekësore) e cila ofron këtë program studimi ka në përbërje të saj 4 Njësi Bazë dhe 1

<p>kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Qendër Kërkimore Shkencore, përfshirë këtu edhe Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili është përgjegjës për këtë program studimi. Sipas statutit të Institucionit (neni 3) objektivat kryesore fokusohen në Kërkim, Mësimdhënie dhe Kontribut për Shoqërinë Departament ka si qëllim mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore në fusha kërkimi të përafërta me fushën e Njësisë kryesore. Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit ky program studimi është i nivelit 7 dhe siguron kualifikime e specializime për studentët e infermierisë. Sipas IAL-së, ky program studimi është kodifikuar sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve si dhe kodifikimit të hapësirës evropiane International Standard Classification of Education ISCED.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030.
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është përgjegjës për këtë program studimi. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ofron programe inovative të cilat janë hartuar nga profesorë të kualifikuar. Ky departament siguron një arsim cilësor në kujdesin shëndetësor, shërbimet komunitare, praktikën dhe mentorimin profesional. Misioni i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë është të edukojë profesionistët e së ardhmes, të fokusuar në të mirën dhe përfitimin e individit dhe shoqërisë, duke synuar të luajë një rol aktiv në zhvillimin e fushës së infermierisë dhe fizioterapisë, duke promovuar shëndetin në Shqipëri, në Ballkan dhe më gjerë. Kjo Njësi Bazë ofron programe studimi Bachelor në Fizioterapi dhe Infermieri. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë synon të ofrojë një kurrikulë me cilësi të lartë, të implementuar në mjedise moderne për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke zhvilluar studentë të vetë-motivuar në ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe duke përmirësuar standardet globale të shëndetit në të gjithë rajonin. Studentët e regjistruar janë të përfshirë në një sërë përvojash të kujdesit për pacientët që u ofrojnë atyre njohuri themelore. Mungesa e Rregullores së Njësisë Bazë është një pikë e dobët e Institucionit.</p> <p>Evidenca:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njesisë bazë dhe kryesore. 				
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Jo e aplikueshme pasi ky është një program studimi Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Ky program studimi operon që prej vitit 2022 dhe nuk raportohen aktivitete të institucionit me punëdhënësit për të diplomuarit, pasi brezi i parë nuk është ende diplomuar. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë organizon rregullisht aktivitete të ndryshme trajnuese në bashkëpunim me punëdhënësit si dhe me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Zyrën e të Diplomuarve (nenet 47-48 të Evidencës 1.13).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njesisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.13-Rregullorja mbi organizimin administrativ. 				
Konkluzione	<p><i>WB është krijuar me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike ka në përbërjen e vet 9 anëtarë me kohë të plotë. Staf i akademik i përfshirë në mësimdhënie ka kapacitetet e nevojshme ndërsa infrastruktura është e përshtatshme për ofrimin e programit të studimit. Fusha e përgjithshme si dhe fusha specifike e programit të studimit Masteri i Shkencave në “Infermieri” është në përputhje me fushën akademike të Njësive Kryesore dhe Bazë që ofrojnë këtë program studimi. Kjo Njësi Bazë ofron programe studimi Bachelor në Fizioterapi dhe Infermieri. Ky program studimi operon që prej vitit 2022 dhe nuk raportohen aktivitete të institucionit me punëdhënësit për të diplomuarit, pasi brezi i parë nuk është ende diplomuar. Njësia Bazë nuk ka rregullore dhe kjo është një pikë e dobët.</i></p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni WB ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara qartë në Rregulloren mbi Organizimin Administrativ dhe në Rregulloren mbi Organizimin Akademik detyrat e personelit. Në raportin vjetor të Njesisë Bazë raportohen arritjet si dhe aktivitetet e zhvilluara. <i>GVJ konsideron si të rëndësishme përgatitjen e analizave të vazhdueshme me qëllim përmirësimin e programit të studimit.</i> Duke patur parasysh që ky program studimi ofrohet që prej vitit 2022, analizat për këtë program janë shumë të rëndësishme me qëllim evidentimin e problemeve dhe marrjen e masave për kapërcimin e tyre. Departamenti organizon mbledhje rregullisht për planifikimin e punëve respektive.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullorja mbi organizimin administrative; - Evidenca 1.14-Rregullorja mbi Organizimin Akademik; - Evidenca 1.15 Vendimi i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve viti akademik 2023-2024; - Evidenca 1.16 Vendim i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës; - Evidenca 1.17 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e Këshilltarit Akademik (1).
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me</p>	<p>Me qëllim realizimin e procesit mësimor, WB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ndërkombëtarizimi dhe partneriteti është një nga fushat strategjike të Institucionit. Sipas raportit vjetor të Njesisë Bazë, në kuadër të këtij programi studimi janë nënshkruar disa marrëveshje mirëkuptimi përfshirë këtu Universitetin e</p>




<p>institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Mjekësisë si dhe IAL në Kosovë, Itali, Poloni etj. Po ashtu, WB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitale private si dhe aktorë të tjerë në funksion të këtij programi studimi. Paralelisht, Institucioni raporton se është në diskutime me dy qendra rehabilitimi në Gjermani dhe Austri që do ti vinë në funksion këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030; - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njesisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.18 Draft marreveshje me institucione partnere per zhvillimin e internshipeve dhe praktikave profesionale Shqip; - Evidenca 1.19 Lista totale e marreveshjeve te bashkepunimit WBU.
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Për ofrimin e këtij programi studimi, Institucioni raporton se ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme si dhe me spitale/klinika për realizimin e praktikave mësimore. Praktika profesionale është pjesë integrale për këtë program studimi. Paralelisht, institucioni raporton se mbështet mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. <i>Nuk u raportuan mobilitete të studentëve të këtij programi studimi. Nuk u raportuan marrëveshje ndërinstitutionale KAI për mobilitet të stafit akademik dhe studentëve (me përjashtim një marrëveshje me Universita degli Studi “G. D’Annuzio” Chieti - Pescara). GVJ konsideron të rëndësishme nënshkrimin e marrëveshjeve KAI me qëllim mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.</i> GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e Institucionit për nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera. Në kuadër të kësaj ka nënshkruar dhe marrëveshje bashkëpunimi me Median Reha Zentrum, Bernkastel Kues si dhe është në diskutime për marrëveshje me Sanlas Holding, dhe University of Graz, Graz, Austri.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi; - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njesisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.19 Lista totale e marreveshjeve te bashkepunimit WBU;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.21 Manual i Organizimit dhe Vleresimit te Praktikës Profesionale; - Evidenca 1.22-Lista e marrëveshjeve për EPIC; - Evidenca 1.24-Lista e studenteve pjese e mobiliteteve. 			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia Bazë harton raportin e saj të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Në këtë raport përfshihen marrëveshjet që Institucioni ka, kohëzgjatja e tyre, data e nënshkrimit, fusha e bashkëpunimit por nuk ka ndonjë raport specifik mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese. GVJ konsideron si të rëndësishëm që Njësia Bazë në bashkëpunim edhe me Zyrat respektive të hartojë rregullisht një analizë mbi rezultatet specifike të marrëveshjeve të nënshkruara. Bashkëpunimi i deritanishëm midis Njesisë Bazë dhe Zyrës së Marrdhënieve me jashtë është efektiv. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara në Institucion.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.26 - Raporti vjetor 2022-2023_Departamenti_Infermieris & Fizioterapise; - Takim me autoritetet drejtuese. 			
Konkluzione	<p>Institucioni WB ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara qartë në Rregulloren mbi Organizimin Administrativ dhe në Rregulloren mbi Organizimin Akademik detyrat e personelit. Me qëllim realizimin e procesit mësimor, WB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme arsimore brenda dhe jashtë vendit dhe me spitale/klinika për realizimin e praktikave mësimore. Nuk u raportuan mobilitete të studentëve të këtij programi studimi. Nuk u raportuan marrëveshje ndër-institucionale KA1 për mobilitet të stafit akademik dhe studentëve. GVJ konsideron si të rëndësishëm që Njësia Bazë në bashkëpunim edhe me Zyrat respektive të hartojë rregullisht një analizë mbi rezultatet specifike të marrëveshjeve të nënshkruara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Infermier” është hapur në vitin 2022 dhe është i organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe me sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (niveli 7 i kualifikimeve sipas përcaktimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) me total 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike. Sipas Rregullores së WB (neni 52) programet e studimit janë të organizuara në module/disiplina dhe të vlerësuara në kredite. Një kredit është i barabartë me 25 orë ndërsa në total në vit, një student zhvillon 1500 orë. Sipas nenit 52 të Rregullores së WBU, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga leksione, seminare, detyra kursi, laborator dhe projekte të praktikës. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme: a. lëndë bazë; b. lëndë karakterizuese; c. lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; d. lëndë plotësuese; e. detyrime përmbyllëse.</p> <p>Plani mësimor i programit Master i Shkencave në “Infermieri” me profilet përkatëse është i organizuar në 2 (dy) vite, 4 (katër) semestra, me nga 32 (tridhjetë e dy) javë në vit, përfshirë edhe javët e provimeve. Programi përbëhet nga 120 kredite ECTS. Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit të studimit është si më poshtë: T-Orë Teorike / P- Orë Praktike / K- Kredite sipas sistemit Amerikan dhe kredite sipas sistemit ECTS.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.
<p>Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh,</p>	<p>Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dyte, është pajisja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushat e specialitetit me anë të studimeve, praktikës dhe kryerjes së kërkimit shkencor në to. Njohuritë që ofrohen nga këto programe dhe kompetencat që</p>

<p>jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>marrin studentët nëpermjet tyre krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike, duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Programet e studimeve të ciklit të dytë janë konceptuar si harmonizim i njohurive, duke filluar me ato bazë teorike, të fushës dhe ndihmëse dhe duke vijuar me thellime në fushat specifike. Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtjshëm të studentëve të Infermierisë në profilet përkatëse. Në këtë program kanë mundësi të studiojnë studentë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në fushën e Infermierisë dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre. Programi i studimit synon të përgatisë gjithashtu dhe studiues të ardhshëm duke u dhënë mundësinë e avancimit drejt një karriere në fushën akademike dhe klinike. Masteri i Shkencave në “Infermieri” me profile synon të formojë të diplomuarit në profilet përkatëse si ekspertë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e përkujdesjes infermiore dhe sigurinë e pacientit. Ata do të jenë zgjedhja e parë si partnerë për punë ndërdisiplinore në kujdesin ndaj pacientit dhe promovimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Të diplomuarit nga ky program studimi do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre në fushën akademike ose/edhe në fushën klinike, në institucione të arsimit të lartë, në institucione shëndetësore publike ose private, në spitale, organizata brenda sistemit shëndetësor, shërbime geriatrike, dhe shërbime të shëndetit mendor. Objektivat specifike që arrihen përmes këtij program studimi përcaktohen në Rregulloren e programit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën</p>	<p>Ky program studimi ka në total 120 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda dy (2) viteve akademike. Në programin e studimit</p>




<p>në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Master Shkencor në Infermieri, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen 12 kredite për lëndët bazë, 60 kredite për lëndët karakterizuese, 18 kredite për lëndët ndërdisiplinore, 12 kredite për lëndët plotësuese dhe 18 kredite për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Në planin mësimor, veprimtaritë formuese janë të përcaktuara qartë. Kreditet dhe orët për secilën lëndë/modul paraqiten në planin mësimor. Për praktikën profesionale parashikohen 12 kredite dhe 18 kredite për detyrimet përmbyllëse (provimi pwrfundimtar).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F); - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor.
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><i>Jo e aplikueshme.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë</p>	<p><i>Jo e aplikueshme.</i></p>

mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<i>Jo e aplikueshme.</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70	Në takimin e zhvilluara me autoritetet drejtuese, ata konfirmuan se ky program studimi është i ngjashëm me programe studimi të Infermierisë në Shqipëri dhe më specifikisht me programin e ofruar në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Evidenca: - <i>Takim me autoritetet drejtuese.</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni ka raportuar pranë MAS propozimin për kodifikimin e këtij programi studimi. Ky proces pritet të finalizohet nga MAS në afatet e përcaktuara kohore. Modulet/lëndët kanë kod specifik. Evidenca: - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor.</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky është një program që ofrohet vetëm nga Western Balkan University.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Shkencor në "Infermieri" është hapur në vitin 2022 dhe është i organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe me systemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të</i>

	<p><i>Krediteve (niveli 7 i kualifikimeve sipas përcaktimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) me total 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.</i></p> <p><i>Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, perbëhen nga leksione, seminare, detyra kursi, laborator dhe projekte të praktikës. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme: a. lënde bazë; b. lënde karakterizuese; c. lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; d. lëndë plotësuese; e. detyrime përmbyllëse. Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dyte, është pajisja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushat e specialitetit me anë të studimeve. Për praktikën profesionale parashikohen 12 kredite dhe 18 kredite për detyrimet përmbyllëse (provimi përfundimtar).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga WB. Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike) ka në përbërjen e vet 4 Njësi Bazë (Departamentit i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imaxherisë, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamentit i Mjekësisë dhe Departamenti i Kirurgjisë). Po ashtu, Njësia Kryesore ka dhe Qendrën Kërkimore Shkencore për Studimin e Sëmundjeve të Rralla. Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total 52 staf akademik nga të cilët 36 personel akademik me kohë të plotë (PAE). Aktualisht (viti akademik 2023-2024), Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 8 (2 Prof. Assoc., 2 Dr. dhe 4 MSc.) personel akademik PAE dhe 6 personel akademik me kontratë (1 Prof. Dr., 2 Dr., dhe 3 MSc.). Institucioni ka zhvilluar akreditimin e parë Institucional dhe është në pritje të rezultatit të akreditimit.</p>				
	Viti akademik	PAE		PAK	
		Nr.	Titulli grada	Nr.	Titulli grada

	2023-2024	0	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.
		2	Prof. Asoc.	0	Prof. Asoc.
		2	Dr.	2	Dr.
		0	Dr. në process	0	Dr. në process
		5	MSc.		MSc.
	2022-2023	0	Prof. Dr.	0	Prof. Dr.
		2	Prof. Asoc.	0	Prof. Asoc.
		2	Dr.	3	Dr.
		0	Dr. në process	0	Dr. në process
		4	MSc.	7	MSc.
Evidenca:					
<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Tabela 6. Staf i Akademik për programin Masteri Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F); - Evidenca 2.14 Tabela 1 Numri i personelit akademik. 					
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.		<p>Nenet 35-36 përcaktojnë rolin dhe funksionet e personelit ndihmës akademik dhe administrativë në WBU. Rregullorja mbi organizimin organizativ përcakton të detajuara pozicionet e stafit administrative si dhe detyrat e tyre. Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit Masteri Shkencor në “Infermieri” ka në përbërje të vet 2 staf ndihmës akademik. Ky staf ndihmës akademik u raportua në takimet e zhvilluara se ishte dhe student pranë këtij institucioni. Një nga studentet e programit të studimit Masteri Shkencor në “Infermieri”, ishte pjesë e stafit ndihmës akademik pranë këtij institucioni.</p>			
		Evidenca:			
		<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.5 Tabela 6. Staf i Akademik për programin Masteri Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.13-Rregullorja mbi organizimin administrative; - Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F); - Evidenca 2.14 Tabela 1 Numri i personelit akademik. 			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e		<p>Njësia Bazë ka të përcaktuar rolin e koordinatorit të programit të studimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Pavarësisht kësaj, nuk ka caktuar një person specifik në rolin e koordinatorit por këtë e bën Drejtuesi i Njesisë Bazë. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë. Ata raportuan</p>			

<p>koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>për rolin e Këshilltarit Akademik i cili mundohet të jetë në kontakt me studentët për të raportuar problematikat e ndryshme si dhe për programin e studimit në përgjithësi. Kjo u konfirma dhe në takimin me studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.15 Pershkrimi i punes se koordinatorit te departamentit; - Evidenca 2.16 Pershkrim i punes se keshilltarit akademik; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përmbush të gjithë detyrimet ligjore përsa i përket organizimit. Njësia Bazë ka të përcaktuar rolin e koordinatorit të programit të studimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i cili në rastin konkret mbulohet nga Drejtuesi i njesisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Në vizitën e zhvilluar në Institucion u raportua se pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj. <i>Ka një mungesë të Rregullores së Njesisë Bazë dhe kjo sugjerohet të rregullohet sa më shpejt të jetë e mundur.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.12 CV-të e personelit akademik të programit; - Evidenca 1.14-Rregullorja mbi Organizimin Akademik; - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor;

<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p style="text-align: center;">- <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i></p> <p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm. Ky program studimi ka 120 ECTS të ndara në dy vite (60 kredite në vit – 30 kredite për semestër). Informacion mbi ngarkesën mësimore, modulet, orët në auditor dhe jashtë tij janë të detajuara. Plani mësimor për programin e studimit Master Shkencor në “Infermieri” është i ndarë në lëndë bazë (12 kredite), karakterizuese (60 kredite), ndërdisiplinore (18 kredite), plotësuese (12 kredite) dhe detyrimet përmbledhëse (18 kredite). Sipas planit mësimor, ky program studimi ka gjithësej 1095 orë në auditor nga të cilat 555 orë janë leksione, 255 janë seminare, 15 orë laboratore dhe 270 orë praktik profesionale dhe lëndore. Orët jashtë auditorit janë të përcaktuara në 1905 orë. Semestrin e parë studentët zhvillojnë pesë (5) lëndë, semestrin e dytë pesë (5) lëndë, semestrin e tretë pesë (5) lëndë ndërsa semestrin e katërt zhvillohet praktika profesionale si dhe tema e diplomës. <i>GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe është e nevojshme që të rriten. Paralelisht, GVJ vëren se të gjitha lëndët kanë të njëjtën ngarkesë në kredite (gjashhtë – 6 ECTS). Kjo sugjerohet të ndryshohet pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën peshë. Po ashtu GVJ vëren se lëndë të cilat kanë formatin 2 orë leksion dhe 1 orë seminar kanë të njëjtin numër kreditesh si lëndë të cilat kanë 3 orë leksion dhe 1 orë seminar.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F);</i> - <i>Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor.</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Neni 54-54 i Rregullores së Institucionit përmban informacionin e përgjithshëm për pranimet, ndërsa neni 69 përmban informacion mbi transferimin e studimeve. Njohja e studimeve të mëparshme është e mundur dhe informacion jepet në nenet 66-68. Kriteret e pranimit janë të detajuara në Rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve (neni 12), ndërsa informacion për transferimin e studimeve jepet në nenin 23. Në rregulloren e programit të studimit nuk jepen informacione për kriteret e pranimit si dhe për ekuivalentimin e studimeve. Informacion jepet për transferimin e studimeve (neni 7) si dhe njohjen e krediteve më parë (neni 9).</p>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm që duhet të kenë sipas akteve ligjore. Ato përfshin emërtimin e lëndës, titullarin e lëndës, ngarkesën (përfshirë këtu leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, kreditet etj.), vitin akademik dhe semestrin që zhvillohet lënda, llojin e lëndës, etj. Paralelisht, përfshihen konceptet themelore, rezultatet e të nxënimit, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi, literatura etj. Në vlerësimin e GVJ, syllabuset ishin sipas parashikimeve ligjore dhe në përputhje me formatet e miratuara. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e elementëve të nevojshëm të syllabuseve të përmenden në Rregulloren e WBU si dhe/ose në rregulloren e programit të ciklit të dytë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri.
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Ky është një program i ri studimi nga i cili këtë vit do të diplomohet brezi i parë i studentëve. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë raportuan se programi është në përmirësim të vazhdueshëm ndërsa stafi akademik raportoi se në fillim të vitit akademik bëhen përmirësimet e nevojshme në bazë të problematikave të ndryshme. <i>GVJ nuk pati mundësinë të evidentonte ndryshime/përmirësime për këtë program studimi deri në këtë moment. Në vlerësimin e GVJ, autoritetet drejtuese duhet të vlerësojnë rregullisht ecurinë e programit duke bërë përmirësimet e nevojshme.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Ky program studimi ka gjithësej 1095 orë në auditor nga të cilat 555 orë janë leksione, 255 janë seminare, 15 orë laboratore dhe 270 orë praktik profesionale dhe lëndore. Orët jashtë auditorit janë të përcaktuara në 1905 orë. GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe është e nevojshme që të rriten. Paralelisht, GVJ vëren se të gjitha lëndët kanë të njëjtën ngarkesë në kredite (gjashtë – 6</i></p>




	<i>ECTS). Kjo duhet të ndryshohet pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën peshë. Kriteret e pranimit, transferimi dhe ekuivalentimi raportohen në dokumnetacionet e IAL-së. Syllabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm që duhet të kenë sipas akteve ligjore. Autoritetet drejtuese duhet të vlerësojnë rregullisht ecurinë e programit duke bërë përmirësimet e nevojshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve të Infermierisë në profilet përkatëse. Në këtë program kanë mundësi të studiojnë studentë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në fushën e Infermierisë dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre. Programi i studimit synon të përgatisë gjithashtu dhe studiues të ardhshëm duke u dhënë mundësinë e avancimit drejt një karriere në fushën akademike dhe klinike. Në tre semestret e para parashikohen nga pesë lëndë (bazuar në profilet respektive), ndërsa studentët zhvillojnë praktik lëndore si dhe praktik profesionale. Njohuritë e marra u japin mundësinë studentëve të thellojnë njohuritë e tyre në fushën respektive. Paralelisht, ata kanë mundësinë të punësohen ose të vazhdojnë studimet e tyre. <i>GVJ konsideron të rëndësishme që të korrigohet plani mësimor pasi të gjitha lëndët kanë të njëjtin numër kreditesh.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor; - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Objektivat formuese të programit të studimit janë të pasqyruara qartë në nenin 3 të Rregullores së programit të studimit. Lëndët janë të shpërndara në katër semetra me një total 120 kredite (60 kredite në vit). Semestrin e parë, të dytë dhe të tretë studentët zhvillojnë pesë (5) lëndë ndërsa semestrin e katërt (4) zhvillojnë praktikën profesionale (12 kredite) dhe punimin e diplomës (18 kredite). Sipas planit mësimor, ky program studimi ka gjithësej 1095 orë në auditor nga të cilat 555 orë janë leksione, 255 janë seminare, 15 orë laboratore dhe 270 orë praktik profesionale dhe lëndore. Zhvillimi i praktikës mësimore u raportua dhe nga studentët dhe stafi akademik gjatë takimeve në Institucion. Orët jashë auditorit janë të përcaktuara në 1905 orë. Semestrin e parë studentët zhvillojnë pesë (5) lëndë, semestrin e dytë pesë (5) lëndë, semestrin e tretë pesë (5) lëndë ndërsa semestrin e katërt zhvillohet praktika profesionale si dhe tema e diplomës. Rezultatet e pritshme të të nxëniet paraqiten në syllabuset respektive. Në takimin e zhvilluar si me stafin akademik por edhe me studentët, ata konfirmuan se përmes lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi, është e mundur arritja e objektivave. <i>GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe është e nevojshme që të rriten. Paralelisht, GVJ vëren se të gjitha lëndët kanë të njëjtën ngarkesë në kredite (gjashtë – 6 ECTS). Kjo duhet të ndryshohet pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën peshë. Po ashtu GVJ vëren se lëndë të cilat kanë formatin 2 orë leksion dhe 1 orë seminar kanë të njëjtin numër kreditesh si lëndë të cilat kanë 3 orë leksion dhe 1 orë seminar.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F); - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor; - Takim me stafin akademik; - Takimi me studentët.

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë ata raportuan se programi është i ngjashëm me programe studimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Pavarësisht kësaj, nuk kishte ndonjë program specifik i cili u raportua nga ata që është bërë krahasimi.</i> Me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale, studentët zhvillojnë 270 orë praktikë profesionale dhe lëndore. Në rastet më të shumta është përdorur një raport 2 ose 3 orë leksion, 1 orë seminar dhe 1 orë praktik. GVJ konsideron se raportet duhet të rikonsiderohen në bazë të rëndësive të lëndëve dhe jo të gjitha lëndët të kenë të njëjtin raport.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F);</i> - <i>Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha veprimtaritë formuese sipas legjislacionit në fuqi (përfshirë këtu formim teorik dhe praktik). Në total përfshihen 3000 orë nga të cilat 1095 orë në auditor dhe 1905 jashtë auditorit (përfshirë këtu 270 orë praktikë). Plani mësimor për programin e studimit Master Shkencor në “Infermieri” është i ndarë në lëndë bazë (12 kredite), karakterizuese (60 kredite), ndërdisiplinore (18 kredite), plotësuese (12 kredite) dhe detyrimet përmbledhëse (18 kredite). Përfundimi i studimeve në Master Shkencor në “Infermieri” ju ofron mundësinë studentëve të transferohen, të kryejn mobilitete ose të punësohen. Rregullorja e programit të studimit (neni 7), rregullorja e studimeve të ciklit të dytë të studimeve (neni 23) dhe rregullorja e institucionit (neni 66) përcaktojnë mundësinë e transferimit të studentëve. Në takimet e zhvilluara u raportua që nuk janë zhvilluar mobilitete në këtë program studimi. Mundësi punësimi pas diplomimit në këtë program studimi kanë studentët u raportua nga drejtuesit e institucionit. <i>Kjo nuk ishte e mundur të verifikohej nga GVJ pasi nuk janë ende studentë të diplomuar në këtë program studimi.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 2.12 Aneks tabela si dhe Tabela 9 Tipi i Veprimtarisë (A-F); - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në fillim të semestrit syllabuset rishikohen nga lektorët e lëndëve të cilët zhvillojnë përditësimet e nevojshme. Kjo është një procedurë që u konfirmua nga stafi akademik dhe nga autoritetet drejtuese. Ata raportuan se mundohen të përditësojnë syllabuset duke përdorur literaturë bashkëkohore (bazë dhe ndihmëse) dhe të pesë viteve të fundit. Pavarësisht kësaj, GVJ nuk arriti të evidentonte përditësimet të syllabusave. Kjo për shkak se ky është një program ende i ri dhe nuk ka diplomuar brezin e parë akoma.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.2 Syllabusi i Praktikës Profesionale; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ka si qëllim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ofrojë kujdes infermieror të bazuar në evidenca, me në qendër pacientin popullatave të ndryshme, në një gamë të gjerë mjedisesh, duke përdorur lidërshtipin, arsyetimin klinik, teknologjinë, vlerësimin për dallimet kulturore dhe sociale dhe edukimin shëndetësor; - Ndikojë në zhvillimin e politikave nëpërmjet zbatimit të strategjive të hartuara për të promovuar barazinë në shëndetësi dhe kujdesin shëndetësor. - Komunikojë dhe bashkëpunojë në mënyrë efektive si një anëtar i ekipit të kujdesit shëndetësor për të ofruar, integruar, koordinuar dhe vlerësuar kujdesin për individë, familje, komunitete dhe popullata të ndryshme. - Përmirësojë cilësinë dhe aksesin në kujdesin shëndetësor nëpërmjet përdorimit të metodave të përmirësimit të cilësisë të bazuara në evidencë, inovacion, teknologji;




	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikojë aftësië drejtuese, aftësi në vendimmarrje për të promovuar kujdesin cilësor, të aksesueshëm dhe të sigurt të pacientit. - Merrë pjesë në promovimin e shëndetit të bazuar në popullatë dhe strategjitë e parandalimit të sëmundjeve me individë, familje, komunitete dhe popullata të ndryshme. - Demonstrojë një përkushtim ndaj të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional në adresimin e nevojave të individëve, familjeve, komuniteteve dhe popullatave të ndryshme në një sistem të kujdesit shëndetësor gjithnjë në zhvillim; - Kontribuojë në kërkimin shkencor sipas fushës specifike. <p>GVJ konsideron se përmbajtja e programit u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e synuara.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i> 				
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit u jep mundësinë studentëve të vazhdojnë studimet e tyre ose të punësohen. <i>Nuk ishte e mundur kjo të verifikohet nga GVJ pasi këtë vit do të diplomohet brezi i parë i studentëve.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i> 				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ky program studimi ka gjithësej 1095 orë në auditor nga të cilat 555 orë janë leksione, 255 janë seminare, 15 orë laboratore dhe 270 orë praktik profesionale dhe lëndore. GVJ konsideron të rëndësishme që të korrigjohet plani mësimor pasi të gjitha lëndët kanë të njejtin numër kreditesh. GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe është e nevojshme që të rriten. Programi i studimit përmban të gjitha veprimtaritë formuese sipas legjislacionit në fuqi. GVJ nuk arriti të evidentonte përditësime të syllabusave. Kjo edhe për shkak se ky është një program ende i ri dhe nuk ka diplomuar brezin e parë akoma.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="577 1794 783 1870">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="783 1794 973 1870">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="973 1794 1179 1870">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1179 1794 1385 1870">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>WBU ka zhvilluar një studim tregu para se të bënte kërkesën për hapjen e këtij programi studimi. Paralelisht, merr në konsideratë mendimet e studentëve dhe stafit akademik përmes instrumentave të cilat ka përgatitur. Nuk ishte e mundur të evidentohej konsultim me të diplomuar pasi sivjet do të diplomohet brezi i parë i studentëve. GVJ konsideron të rëndësishme që WB ka ndërtuar bashkëpunime të qëndrueshme me institucione shëndetësore si spitali Amerikan dhe Hygeia. Kjo i jep mundësinë përshtatjen e programit rregullisht në bazë të nevojave të tregut të punës. <i>Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në NJSBC ndihmon në përmirësimin e programit të studimit dhe GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi; - Evidenca 2.18-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien; - Evidenca 2.25 Studim tregu të hapjes së programit; - Evidenca 2.26-Raporti vjetor 2022-2023_Departimenti_Infermieris&Fizioterapise; - Evidenca 2.24- Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 3.3- Kalendari i punës NJSBC 2022-2023 dhe 2023-2024; - Evidenca 6.1 Raport mbi propozimin për hapje të programeve të reja.
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me</p>	<p>Studentët e WBU janë të përfshirë në organet kolegjiale të institucionit. Ata janë pjesë e Senatit Akademik, NJSBC etj. Studentët marrin pjesë në konsultime të ndryshme si dhe japin mendime dhe opinione përmes përfaqësuesve të tyre. Paralelisht, studentët kanë kontakte të rregullta me këshilltarin akademik.</p>

<p>studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur klubet studentore të cilën GVJ e konsideron si një praktikë të mirë. WBU ka hartuar një pyetësor për cilësinë e programit të studimit për studentët që do të diplomohen.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.17 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e Këshilltarit Akademik (1); - Evidenca 2.16 Pershkrim i punes se keshilltarit akademik; - Evidenca 2.21 Organizimi i klubeve studentore; - Evidenca 2.22 Pyetsor per vleresimin e programit te studimit nga studentet qe diplomohen; - Evidenca 2.29 Raporti i aktiviteteve të Klubeve; - Evidenca 6.11 Emerimi i studentit në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Takimi me studentet. 			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Ky është një program i ri studimi dhe nuk është përditësuar ende. IAL ka të drejtë të kryejë ndryshimet eventuale vetëm pasi të marrë akreditimin e parë. Në takimet e zhvilluara u konfirmua se ata do të bashkëpunojnë me rrjetet e profesionistëve si dhe Urdhërin e Infermierit për përditësimin e nevojshëm të programit të studimit. Me këtë qëllim, WBU organizon rregullisht aktivtete të ndryshme me shoqata mjekësore (psh. Kryqi i Kuq).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi; - Evidenca 1.11 Raportim mbi pjesëmarrjen ne konferencen mjekesore nga Urdheri i Infermierit; - Evidenca 2.23 Raport i Workshopit nga Kryqi i Kuq; - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU ka zhvilluar një studim tregu para se të bënte kërkesën për hapjen e këtij programi studimi. Paralelisht, merr në konsideratë mendimet e studentëve dhe stafit akademik përmes instrumentave të cilat ka përgatitur. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në NJSBC ndihmon në përmirësimin e programit të studimit dhe GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë. Institucioni ka ngritur klubet studentore të cilën GVJ e konsideron si një praktikë të mirë. WBU ka hartuar një pyetësor për cilësinë e programit të studimit për studentët që do të diplomohen. Ky është një program i ri studimi dhe nuk është përditësuar ende.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Ekselencia në kërkim dhe ekselencia në edukim janë dy nga fushat kryesore strategjike të cilat përcaktohen në Planin Strategjik të Institucionit. Objektivat kryesore të programit të studimit përcaktohen qartë në nenin 3 të Rregullores së programit të studimit. GVJ konsideron se ato janë në përputhje me objektivat madhorë të WBU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.4- Plani Strategjik 2023-2030.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>WBU respekton lirinë akademike sipas legjislacionit në fuqi. Neni 5 i statutit të WBU përcakton lirinë akademike. Stafit akademik raportoj se kanë mundësi të zhvillojnë studime kërkimore shkencore në fushën e tyre të studimit në bazë të preferencave dhe prioritetëve të Njesisë Kryesore/Bazë. Sipas nenit 12 të Statutit, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron, si dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë programin e studimit. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Përmes aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon, studentët kanë mundësi të angazhohen në aktivitete kërkimore, studime ose/edhe projekte. Ata kanë mundësi të marrin njohuri kërkimore përmes lëndës së "Metodat e Kërkimit Shkencor" që zhvillohet në semestrin e tretë. Po ashtu, studentët në lëndë të ndryshme zhvillojnë projekte individuale ose në grup. Në takimin me</p>




	<p>studentët, u raportua se kanë zhvilluar punime shkencore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Paralelisht, përmes temës së diplomës, studentët kanë mundësi të zhvillojnë punime kërkimore shkencore.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.11 Raportim mbi pjesëmarrjen në konferencën mjekesore nga Urdheri i Infermierit; - Evidenca 1.25 Raportim Konference_imazheria e Gjirit; - Takim me studentet. 								
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Njësia Bazë mbështetet financiarisht nga Institucioni për organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Mobilitet i stafit është zhvilluar si dhe i studentëve duke përdorur të ardhura të institucionit. Njësia Bazë nuk menaxhon të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme por ato menaxhohen në nivel universiteti. <i>GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e stafit akademik është mbështetur financiarisht nga WBU dhe kjo është diçka mbi të cilën duhet të punohet më shumë. Kjo vin dhe si pasojë e funksionimit vetëm 2 vjeçar të Institucionit.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.23- Të dhëna për mobilitetin e personelit; - Evidenca 1.24-Lista e studenteve pjese e mobiliteteve; - Evidenca 1.27 Modalitet i mbështetjes institucionale per leje per arsye akademike per personelin. 								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ekselencia në kërkim dhe ekselencia në edukim janë dy nga fushat kryesore strategjike të cilat përcaktohen në Planin Strategjik të Institucionit. WBU respekton lirinë akademike sipas legjislacionit në fuqi. Neni 5 i statutit të WBU përcakton lirinë akademike. Përmes aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon, studentët kanë mundësi të angazhohen në aktivitete kërkimore, studime ose/edhe projekte. Njësia Bazë mbështetet financiarisht nga Institucioni për organizimin e aktiviteteve të ndryshme. GVJ vëren se veëm një pjesë e vogël e stafit akademik është mbështetur financiarisht nga WBU dhe kjo është diçka mbi të cilën duhet të punohet më shumë.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p><i>Deri tani Njësia Bazë nuk ka asnjë projekt kërkimor në implementim dhe kjo është një pikë e dobët që duhet të punohet më shumë.</i> Një nga objektivat kryesor të programit të studimit është rritja e aftësive kërkimore shkencore të studentëve. Departamenti ka në përbërje gupin kërkimor i cili përbëhet nga katër (4) anëtarë nga të cilët një me gradën shkencore Dr. dhe tre (3) të tjerët me Master Shkencor. <i>GVJ konsideron këtë si pikë të dobët dhe është e nevojshme që grupet kërkimore të përfshijnë më shumë anëtarë me grada shkencore dhe tituj akademik.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.9 Organizimi i grupeve kërkimore brënda njësisë bazë.
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët angazhohen për aktivitete kërkimore shkencore. Studentët zhvillojnë studime kërkimore në kuadër të temës së diplomës ose gjatë lëndëve/moduleve të ndryshme. Stafi akademik zhvillon kërkime shkencore. Studentët raportuan se janë përfshirë në punë kërkimore të stafit akademik. Raporti vjetor i Njësisë Bazë përmban informacion mbi kërkimin shkencor. Institucioni vendos në dispozicion ambientet e veta për nevojat e kërkimit shkencor si për stafin akademik ashtu dhe për studentët. <i>GVJ konsideron të rëndësishme rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor me publikime në revista prestigjioze me faktor impakti si dhe aplikimin në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.9 Organizimi i grupeve kërkimore brenda njësisë bazë; - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njësisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.20 Lista e projekteve të brendshëm të financuara nga institucioni; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.




<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Stafi akademik ka marrë pjesë në konferenca shkencore të cilat organizohen nga partner të WBU. <i>Institucioni nuk ka organizuar konferenca deri në këtë moment pasi funksionon dy vite.</i> Autoritetet drejtuese raportuan se po planifikojnë një konferencë shkencore në fushën e infermierisë dhe fizioterapisë. <i>Po ashtu, WBU organizon rregullisht leksione të hapura, workshope, trajnime etj. Aktiviteti i organizuar nga WBU me Fondacionin “Down Syndrome Albania” me temën “Ndërgjegjësimi për personat me aftësi të kufizuar. Kujdesi shëndetësor për personat me aftësi të kufizuar” është një praktik e tillë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njësisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.11 Raportim mbi pjesëmarrjen në konferencën mjekësore nga Urdhëri i Infermierit; - Evidenca 1.25 Raportim Konference_imazheria e Gjirit; - Evidenca 1.28- Raport trajnimi WBU-Down Syndrome Albania; - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve të Infermierisë në profilet përkatëse. Masteri i Shkencave në “Infermieri” synon të formojë të diplomuarit në profilet përkatëse si ekspertë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e përkujdesjes infermierore dhe sigurinë e pacientit. Qëllimi i programit është të përgatisë student për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Deri në këtë moment nuk janë diplomuar student nga ky program studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor;

	- Evidenca 2.25 Studim tregu te hapjes se programit.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Nuk u raportuan bashkëpunime me shoqata profesionale apo rrjete profesionale. Duke qenë se edhe brezi i parë i studentëve nuk është diplomuar akoma, nuk ka të dhëna as nga urdhëri i infermierit në lidhje me kalueshmërinë e tyre dhe marrjen e liçensës. WBU, bashkëpunon me spitale të ndryshme për aftësimin dhe zhvillimin e praktikave nga studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi; - Evidenca 1.18 Draft marreveshje me institucione partnere per zhvillimin e internshipeve dhe praktikave profesionale Shqip. - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. 			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	<p>Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit European. Kjo shikohet si nga mënyra e organizimit të programit të studimit, ashtu edhe nga temat që trajton.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor. 			
Konkluzione	<p>Njësia Bazë nuk ka asnjë projekt kërkimor në implementim dhe kjo është një pikë e dobët që duhet të punohet më shumë. Staf i akademik dhe studentët angazhohen për aktivitete kërkimore shkencore. GVJ konsideron të rëndësishme rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor me publikime në revista prestigjioze me faktor impakti si dhe aplikimin në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Staf i akademik ka marrë pjesë në konferenca shkencore të cilat organizohen nga partner të WBU. Nuk u raportuan bashkëpunime me shoqata profesionale apo rrjete profesionale. Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, ushtrimet, projektet/detyrat, seminarët, praktikat/stazhet si dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor. Institucioni po ashtu parashikon zhvillimin e orëve të hapura. Të gjitha këto janë të parashikuara në rregulloren e WBU si dhe në rregulloren e programit të studimit.

Evidenca:

- Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së;
- Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;
- Evidenca 1.8 Dosja e syllabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri;
- Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor.

<i>Master i Shkencave në "Infermieri"</i>	Viti I	Viti II	Në total	Në total %
Në auditor	600	495	1095	36.5
Leksione	330	225	555	18.5
Seminare	150	105	255	8.5
Laboratore	15	0	15	0.5
Praktika profesionale dhe lëndore	105	165	270	9.0
Punë e pavarur e studentit	900	1005	1905	63.5
Gjithsej	1500	1500	1500	100




<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Gjatë mësimdhënies studentët raportuan se stafi akademik përdor mënyra të ndryshme përfshirë këtu diskutimet, zhvillimin e lirë të pyetjeve etj. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra interaktive duke u munduar të kenë gjithnjë studentin në qendër. Paralelisht, ata përdorin video si dhe mjete të tjera teknologjike me qëllim mësimi të jetë më interesant për studentët. Zhvillimi i trjanimëve dhe leksioneve të hapura u jep mundësinë stafi akademik të rrisë njohuritë mbi përdorimin e metodave alternative dhe jo tradicionale të mësimdhënies. <i>GVJ konsideron të rëndësishme që WBU të hartoj një udhëzues për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.7 Aktivitete te realizuara ne WBU; - Evidenca 6.14 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentet.
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni organizon rregullisht trajnime, orë të hapura, seminare etj. me qëllim përmirësimin e aftësive dhe kompetencave të stafit akademik. Pjesmarrja në aktivitetet që organizon institucioni është pa pagesë ndërsa WBU mundohet të mbështesë stafin financiarisht për pjesmarrje në aktivitete të tjera brenda ose jashtë Shqipërisë. <i>GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi; - Evidenca 2.7 Aktivitete te realizuara ne WBU; - Evidenca 6.14 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC; - Takimi me stafin akademik.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent për të transmetuar njohuritë dhe kompetencat e nevojshme tek studentët. Institucioni ka procedura standarde për rekrutimin e stafit akademik. CV-të e stafit janë të paraqitura nga institucioni. <i>GVJ konsideron se është e rëndësishme që të mbështetet stafi akademik</i></p>




<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademik. Po ashtu, GVJ rekomandon rekrutimin e stafit të tillë. Përdorimi i metodave interaktive gjatë mësimdhënies u konfirmua nga studentët si dhe nga stafi akademik. Mësimdhënia zhvillohet me studentin në qendër ndërsa bashkëbisedimi ndihmon në krijimin e mendimit kritik të studentëve. Respekti i ndërsjellët dhe ndjekja me rigorozitet i kodit të etikës u konfirmua në takimet e zhvilluara.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.5 Tabela 6. Staf i Akademik për programin Masteri Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.12 CV-të e personelit akademik të programit; - Evidenca 1.13-Rregullorja mbi organizimin administrative; - Evidenca 1.14-Rregullorja mbi Organizimin Akademik; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studentët e WBU janë të përfshirë në vlerësimin periodik të lëndëve të cilat zhvillojnë gjatë vitit akademik. Paketa e instrumentave të cilësisë është një pikë e fortë e institucionit të cilën duhet të vazhdojë ta implementoj rregullisht. Klubet studentore janë një mënyrë alternative të cilën institucioni mund të përdori për përmirësimin e programit të studimit. Ndryshime në programin e studimit në bazë të mendimeve dhe opinioneve të studentëve nuk janë zhvilluar ende, duke qenë se ndryshimet mund të aplikohen vetëm pas akreditimit të parë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.22 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen; - Evidenca 2.24- Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 2.28-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik; - Evidenca 2.29 Raporti i aktiviteteve të Klubeve; - Evidenca 6.11 Emerimi i studentit në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Takimi me studentët; - Takim me Përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka në organigramën e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Po ashtu ka ngritur dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Njësia organizon rregullisht aktivitete për përmirësimin e aftësive të stafit akademik. Paralelisht, Njësia ka hartuar dhe paketën e Instrumentave të cilësisë për një vlerësim gjithpërfshirës. Organizimi i trajnimeve, workshop-eve, leksioneve dhe orëve të hapura është një procedurë e rregullt që WBU zhvillon.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 2.9 Struktura organizative e WBU (organigrama); - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluara për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi vjetor; - Evidenca 2.24- Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Takim me Përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, ushtrimet, projektet/detyrat, seminarët, praktikat/stazhet si dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor. GVJ konsideron të rëndësishme që WBU të hartoj një udhëzues për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni organizon rregullisht trajnime, orë të hapura, seminare etj. Pjesëmarrja në aktivitetet që organizon institucioni është pa pagesë ndërsa WBU mundohet të mbështesë stafin financiarisht për pjesëmarrje në aktivitete të tjera brenda ose jashtë Shqipërisë. GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë. GVJ konsideron se është e rëndësishme që të mbështetet stafi akademik për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademik. Po ashtu, GVJ rekomandon rekrutimin e stafit të tillë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Notat, provimet dhe kalueshmëria përcaktohen në rregulloren e institucionit. Neni 89 i Rregullores përcakton vlerësimin, i cili varjon nga nga 4-10. Paralelisht, shpjegohen dhe mënyrat e tjera të vlerësimit me qëllim përshtatjen e tyre me metodat europiane. Kriteret e kalimit në vitin pasardhës përcaktohen në nenin 90 ndërsa nenet 91-95 përcaktojnë pikat e tjera mbi provimin. Rregulloret respective u vihen në dispozicion studentëve përmes sistemit të brendshëm të institucionit si dhe janë të aksesueshme në faqen zyrtare. Studentët raportuan se ishin në dijeni për kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Stafi akademik konfirmoj në takimin e zhvilluar se në fillim të secilës lëndë ata informojnë studentët për përmbajtjen e saj, mënyrën e testimit/vlerësimit si dhe njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që ata pritet të fitojnë. Kjo u konfirmua dhe nga stafi akademik. Syllabuset e lëndëve të cilat u jepen studentëve si dhe ngarkohen në sistemin on-line, parashikojnë të gjitha këto modalitete.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.8 Dosja e syllabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Provimet zakonisht bëhen me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë ta bejë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi. Provimi përgatitet dhe drejtohet nga pedagogu i lëndës perkatëse. Në rast se pedagogu përgjegjës nuk ndodhet në ambientet e Universitetit "Western Balkans" ditën e provimit, atëhere Përgjegjësi i Departamentit përcakton se kush do ta bejë provimin. Të gjithë pedagogët dhe asistentët mund të ngarkohen me detyrë, me qëllim të sigurimit të mbarevajtjes së provimeve. Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi, ose</p>




	<p>kartën e studentit. Studentët që morrën pjesë në takim raportuan se provimet ata kishin bërë me shkrim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Takimi me studentët. 			
Konkluzione	<p>Notat, provimet dhe kalueshmëria përcaktohen në rregulloren e institucionit. Stafi akademik konfirmoj në takimin e zhvilluar se në fillim të secilës lëndë ata informojnë studentët për përmbajtjen e saj, mënyrën e testimit/vlerësimit si dhe njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që ata pritet të fitojnë. Provimet zakonisht bëhen me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë ta bejë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në diskutimin e zhvilluar në Institucion, stafi akademik dhe studentët raportuan se vlerësimi i njohurive dhe dijeve zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik si dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar të studentit. Studentët zhvillojnë dy provime (të pjeshmin dhe përfundimtarin). Po ashtu studentët vlerësohen edhe në bazë të projekteve, detyrave të kursit etj., të cilat janë të parashikuara në syllabuset përkatëse. Kjo gjë u konfirmua nga studentët dhe nga stafi akademik. Studentët që mbledhin më shumë se 49 pikë konsiderohen kalues. Neni 89 i Rregullores së Institucionit përcaktojnë format e vlerësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentet.

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p><i>Institucioni nuk raportoi se përdor sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimit.</i> Staf i akademik raportoi se në disa raste ka përdorur GoogleClassroom por vetëm për hartimin e quiz-eve të cilat më tej printohen dhe u jepen studentëve në klasë. <i>GVJ konsideron se WBU duhet të implementoj sisteme elektronike me qëllim rritjen e transparencës së vlerësimit të studentve.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në bazë të syllabusit të secilës lëndë si dhe legjislacionit në fuqi. Studenti fiton të drejtën për t'u futur në provimin e një lënde kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në syllabusin përkates. Studentit i mohohet e drejta për të hyrë në provim në rastin kur ka detyrime financiare. Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për lënden në syllabusin e saj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Provimet kryhen në ambientet e Universitetit “Western Balkans” në ditën, vendin dhe orën e caktuar në program. Provimet e lëndëve të cilat zhvillohen në terren ose me aplikim, mund të bëhen edhe jashtë godinës së Universitetit. Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë, të gjithë ata janë anetarë të komisionit të vlerësimit. Rezultatet e provimeve shpallen brenda afatit kohor përkatës të përcaktuar në kalendarin akademik. Në rastet që studentët kanë paqartësi, ata mund të pyesin pedagogun e lëndës për gabimet apo pasaktësitë në provim. Kjo procedurë u konfirmua nga staf i akademik dhe studentët gjatë takimeve të zhvilluara.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentet.
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni 13 i Rregullores së programit të studimit përcakton rastet që ndodh plagjaturë. Neni 39 i Rregullores së programeve të ciklit të dytë përcakton detyrimet e studentëve përfshirë këtu rregullat që duhet të ndjekin. Të detajuar këto rregulla paraqiten dhe në syllabuset përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procesverbali duhet të përmbajë firmën e pedagogut të lendës dhe Kordinatorit të Departamentit. Një vlerësim i raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezultoni se është bërë një gabim teknik gjatë regjistrimit ose gjatë hedhjes në kompjuter. Personi përgjegjës për gabimin duhet të vëtoje me shkrim rrethanat e kryerjes së gabimit. Vërtetimi miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej tre ditësh nga dita e konstatimit të gabimit. Rezultatet pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit, në regjistrin e notave dhe në regjistrin elektronik. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se dy javë nga data e mbarimit të sezonit të provimeve. Në asnjë rast procesverbali i vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së.
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Kjo parashikohet në nenin 99 të Rregullores së WBU. <i>Studentët ishin në dijeni të kësaj procedure</i></p>




statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p><i>por ata raportuan se nuk ishin ankuar ndonjëherë për ndonjë notë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së;</i> - <i>Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve;</i> - <i>Takimi me studentët.</i> 			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i behet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së;</i> - <i>Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.</i> 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Stafi akademik dhe studentët raportuan se vlerësimi i njohurive dhe dijeve zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik si dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar të studentit. Institucioni nuk raportoi se përdor sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. GVJ konsideron se WBU duhet të implementoj sisteme elektronike me qëllim rritjen e transparencës së vlerësimit të studentve. Vlerësimi përfundimtar bëhet në bazë të syllabusit të secilës lëndë si dhe legjislacionit në fuqi. Rezultatet e provimeve shpallen brenda afatit kohor përkatës të përcaktuar në kalendarin akademik. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në perfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se dy javë nga data e mbarimit të sezonit të provimeve. Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile: Infermieristikë në Kirurgji; Infermieristikë në Pediatri; Infermieristikë në Obstetrikë dhe Gjinekologji; Infermieristikë në Kujdesin Intensiv; dhe Infermieristikë në Urgjencë ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve të Infermierisë në profilet përkatëse.

Në përfundim të programit Master i Shkencave në “Infermieri” studenti do jetë i aftë të:

- Ofrojë kujdes infermieror të bazuar në evidenca, me në qendër pacientin popullatave të ndryshme, në një gamë të gjerë mjedisesh, duke përdorur lidershipin, arsyetimin klinik, teknologjinë, vlerësimin për dallimet kulturore dhe sociale dhe edukimin shëndetësor.
- Ndikojë në zhvillimin e politikave nëpërmjet zbatimit të strategjive të hartuara për të promovuar barazinë në shëndetësi dhe kujdesin shëndetësor.
- Komunikojë dhe bashkëpunojë në mënyrë efektive si një anëtar i ekipit të kujdesit shëndetësor për të ofruar, integruar, koordinuar dhe vlerësuar kujdesin për individë, familje, komunitete dhe popullata të ndryshme.
- Përmirësojë i cilësinë dhe aksesin në kujdesin shëndetësor nëpërmjet përdorimit të metodave të përmirësimit të cilësisë të bazuara në evidencë, inovacion, teknologji.
- Aplikojë aftësi drejtuese, aftësi në vendimmarrje për të promovuar kujdesin cilësor, të aksesueshëm dhe të sigurt të pacientit.
- Merrë pjesë në promovimin e shëndetit të bazuar në popullatë dhe strategjitë e parandalimit të sëmundjeve me individë, familje, komunitete dhe popullata të ndryshme.
- Demonstrojë një përkushtim ndaj të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional në adresimin e nevojave të individëve, familjeve, komuniteteve dhe popullatave të ndryshme në një sistem të kujdesit shëndetësor gjithnjë në zhvillim.
- Kontribuojë në kërkimin shkencor sipas fushës specifike.

Evidenca:

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri.</i>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plani mësimor përfshinë lëndë të cilat fokusohen në aftësi komunikuese (Bioetikë / Teoria e Komunikimit) dhe teknologjike (Informatikë dhe Infermieristikë). Është me vlerë të theksohet se programi ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.13 Tabela 10 Plani mësimor.</i>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në fund të semestrit (orën e fundit të leksioneve) pedagogët zhvillojnë konsultime me studentët me qëllim orientimin e tyre mbi pikat kryesore. Zhvillimi i konsultimeve u konfirmua edhe në takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët. Gjatë konsultimeve studentët raportuan se informohen mbi çështjet kryesore dhe se ku është e rëndësishme që ata të fokusohen për provimin.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takimi me stafin akademik;</i> - <i>Takimi me studentët.</i>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me</p>	<p>Në syllabuset e secilës lëndë janë të përfshira njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që pritet që studentët të marrin gjatë zhvillimit të tyre. Këto njohuri të cilat ata përfitojnë kanë mundësinë të implementojnë në praktikën lëndore si dhe në praktikën profesionale të cilën ata zhvillojnë. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë mobilitete në IAL jashtë Shqipërisë. <i>Deri në këtë moment, studentët nuk kanë zhvilluar mobilitete jashtë.</i> Institucioni ka bashkëpunime të ndryshme të cilat i përdor për praktikën e studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Tabela 5, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi;</i> - <i>Evidenca 1.8 Dosja e silabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 1.19 Lista totale e marrëveshjeve të bashkëpunimit WBU;</i> - <i>Evidenca 1.24-Lista e studentëve pjesë e mobiliteteve.</i>

<p>institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në WBU rregullisht organizohen dhe realizohen orë të hapura, dhe seminare të ndryshme mbi zhvillimet e shkencës në fusha specifike. Në këto aktivitete marrin pjesë stafi akademik dhe studentët të cilët e konfirmuan këtë në takimet e zhvilluara. <i>Aktiviteti i organizuar nga WBU me Fondacionin “Down Syndrome Albania” me temën “Ndërgjegjësimi për personat me aftësi të kufizuara. Kujdesi shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara” është një praktik e tillë. GVJ e konsideron këtë si praktikë të mirë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.10 Planifikimi vjetor i aktiviteteve kërkimore shkencore të njesisë bazë dhe kryesore; - Evidenca 1.28- Raport trajnimi WBU-Down Syndrome Albania; - Evidenca 3.3- Kalendari i punës NJSBC 2022-2023 dhe 2023-2024; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p><i>GVJ nuk pati mundësinë të verifikoj mbështetjen financiare të studentëve për implementimin e ideve inovative apo studimeve kërkimore të përparuara.</i> Institucioni mbështet mobilitetin e studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.24-Lista e studenteve pjesë e mobiliteteve; - Takim me autoritetet drejtuese.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” me profile ka për qëllim aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike të karakterit të mirëfilltë profesional nga fusha e Infermieristikës. Plani mësimor përfshinë lëndë të cilat fokusohen në aftësi komunikuese (Bioetikë / Teoria e Komunikimit) dhe teknologjike (Informatikë dhe Infermieristikë). Në syllabuset e secilës lëndë janë të përfshira njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që pritet që studentët të marrin gjatë zhvillimit të tyre. Në WBU rregullisht organizohen dhe realizohen orë të hapura, dhe seminare të ndryshme mbi zhvillimet e shkencës në fusha specifike. GVJ nuk pati mundësinë të verifikoj mbështetjen financiare të studentëve për implementimin e ideve inovative.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në semestrin e katërt studenti mund të fillojë punimin e diplomës vetëm pasi të ketë përmbushur me sukses të gjitha kërkesat e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë. Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS sipas përcaktimeve të VKM nr 41. Studentët që ndjekin këtë program studimi iu caktohet një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Në varësi të nevojave të programit të studimit, udhëheqësi mbikëqyr një numër të caktuar studentësh njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave mjekësore teknike. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. Institucioni ka hartuar dhe manualin e hartimit të diplomës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 3.4-Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe</p>	<p>Institucioni ka hartuar manualin e hartimit të diplomës. Në manual përfshihen formati dhe paraqitja e tezës, struktura e tezës, mënyra dhe prezantimi i saj si dhe detyrimet e dorëzimit të saj. Po ashtu jepen dhe shëmbuj të tezës.</p>

<p>materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 3.4-Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në këtë program studimi, studentët diplomohen me temë diplome dhe jo me provim përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti i propozon Fakultetit një drejtues teze për çdo student deri në fund të semestrit përkates dhe një temë të caktuar nga udhëheqësi i tezës jo më vonë se fundi i semestrit të parë për programet e studimit Master Profesional dhe jo më vonë se fundi i semestrit të tretë për programet e studimit Master Shkencor. Mbikëqyrësi dhe tema e propozuar përcaktohen me vendim të Dekanatit mund të bëjë çdo ndryshim të mbikëqyrësi dhe ose tema, ose mund të caktojë një mbikëqyrës të dytë nëse është e nevojshme Udhëheqësi i tezës zgjidhet nga stafi akademik i cili zotëron të paktën një diplomë doktorature për programin e studimit Master Shkencor dhe Master Profesional. Studenti duhet të regjistrohet për tezën deri në fillim të semestrit të katërt për programet e studimit Master i Shkencave. Neni 34 dhe 35 i Rregullores së programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve përcakton të gjitha modalitetet.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve.
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Në rastet që është e nevojshme, WBU asiston studentët për zhvillimin e matjeve, analizave etj. Paralelisht, mundëson mjediset e institucionit kur kanë nevojë studentët për ti përdorur. Kjo u konfirmua dhe në takimin me studentët. Një nga studentët</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>që morri pjesë në takim konfirmoi se po përdor ambientet e institucionit për të zhvilluar temën e diplomës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 3.4-Udhezues për përgatitjen e punimit të diplomës; - Takimi me studentët.
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Neni 5 pika d përcakton se me përfundimin e tezës së diplomës, juria voton me dyer të mbyllura notën dhe nxjerr vendimin që ka marrë në bazë të votave të shumicës. Kjo përcaktohet dhe në nenin 14 të Rregullores së programit të studimeve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve; - Evidenca 3.4-Udhezues për përgatitjen e punimit të diplomës.
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Universiteti pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri.
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Kopje e dokumentacionit ruhej në institucion sipas akteve ligjore. Informacion mbi regjistrat e studentëve jepet në nenin 79 të Rregullores së universitetit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së.

Konkluzione	Në semestrin e katërt studenti mund të fillojë punimin e diplomës vetëm pasi të ketë përbushur me sukses të gjitha kërkesat e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë. Institucioni ka hartuar manualin e hartimit të diplomës. Mbikëqyrësi dhe tema e propozuar përcaktohen me vendim të Dekanatit. Në rastet që është e nevojshme, WBU asiston studentët për zhvillimin e matjeve, analizave etj. Universiteti pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Kopje e dokumentacionit ruhej në institucion sipas akteve ligjore.			
Shkalla e përbushjes sëstandardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Jo e aplikueshme.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Jo e aplikueshme.
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë	Jo e aplikueshme.

studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Jo e aplikueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Në përgjithësi, stafi akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, <i>por sic evidentohet nga tabela e mëposhtme, në programin e studimit janë të angazhuar staf si PAE dhe PAK që janë me nivelin master i shkencave, njësoj me nivelin e kornizës së kualifikimit të programit ku janë të angazhuar si staf. GVJ, në kuadër të garantimit të standardeve të cilësisë së mësimdhënies thekson që institucioni të jetë më i vëmendshëm në këtë drejtim, edhe pse programi është relativisht i ri dhe akoma është në fazat e konsolidimit të qëndrueshmërisë së tij. Në programin e studimit janë të angazhuar dhe 2 staf ndihmës akademik me kualifikim dhe fushë eksperize në përputhje me programin e studimit. <i>GVJ vëren se disa nga stafi akademik ka nivel të njëjtë kualifikimi me ata të</i></i>

programit të studimit. Kjo është një pikë e dobët ku Institucioni duhet të punoj më shumë.

Viti akademik	PAE		PAK	
	Nr.	Titulli grada	Nr.	Titulli grada
2023-2024	0	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.
	1	Prof. Asoc.	0	Prof. Asoc.
	1	Dr.	1	Dr.
	0	Dr. në process	0	Dr. në process
	5	MSc.	3	MSc.
	2	Personel ndihmës akademik		
2022-2023	0	Prof. Dr.	0	Prof. Dr.
	2	Prof. Asoc.	0	Prof. Asoc.
	2	Dr.	3	Dr.
	0	Dr. në process	0	Dr. në process
	4	MSc.	7	MSc.
	2	Personel ndihmës akademik		Personel ndihmës akademik

Evidenca:

- Evidenca 1.1-Statuti i WBU;
- Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së;
- Evidenca 4.1-Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;
- Evidenca 4.2-Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës pr programine studimit;
- Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;
- Vizita në institucion, takimi me drejtues të njesisë bazë, kryesore dhe stafin akademik e ndihmësakademik.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, 5 profile mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Për vitin akademik 2022-2023, raporti i mbulimit të ngarkesës mësimore është 86% PAE dhe 14 % PAK.

	<p>Për vitin akademik 2023-2024, raporti i mbulimit të ngarkesës mësimore është 80% PAE dhe 20 % PAK. Institucioni në funksion të këtij kriteri ka hartuar dhe Udhëzimin për ngarkesën mësimore në Universitetin Western Balkans.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 3.2-Rregullorja e programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 3.2-Udhëzimi për ngarkesën mësimore në Universitetin Western Balkans; - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>WBU garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri nëpërmjet politikave dhe procedurave të miratuara dhe të përcaktuara. Personeli akademik i kategorisë Profesor dhe Lektor në WBU punësohen me kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar kurse kategoria Asistent Lektor me kontratë me kohëzgjatje të caktuar. Në kontratat e punësimit, pavarësisht nga kategoria e stafit përcaktohen qartë dhe specifikisht të gjitha detyrimet dhe të drejtat e të punësuarve. Institucioni respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale të punës si detyrimet financiare, sigurimet shoqërore dhe të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi. Dosjet e personelit që përmbajnë dhe dokumentacionin përkatës ruhen në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Kontratat e punës për stafin akademik dhe ndihmës akademik lidhen nga Rektori pas miratimit të punësimit nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 4.3-Lista e dokumentacioneve në dosjen e personelit; - Evidenca 2.20-Guida e stafit; - Evidenca 4.5-Kontrata e punës së personelit akademik; - Vizita në institucion, takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

WBU ndjek procedura rekrutimi të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri bazuar në kritere të përcaktuara mbi propozimet dhe nevojat e Departamentit të Infermiersisë dhe Fizoterapisë, njësia përgjegjëse për programin e studimit dhe në përputhje me Nenin 71 të Statutit të WBU dhe Rregulloren mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit. Këto kritere më pas marrin miratim nga Rektorati. Shpallja e vendave vakante me informacionin e detajuar të lidhur me pozicionin e punës që kërkohet publikohet në faqen zyrtare web të institucionit <https://wbu.edu.al/en/job-vacancies>. Për ndjekjen e procedurës dhe vlerësimin e aplikantëve të interesuar ngrihet një komision ad-hoc në nivel Dekanati. Kandidati i shpallur fitues para se të nënshkruaj kontratën individuale të punës me Rektorin duhet të marrë miratim paraprak nga Bordi i Administrimit. Procedura e vlerësimin të performancës së stafit akademik bazohet në dy instrumenta, pyetësoin e studentëve dhe formularin e vetëvlerësimin të stafit akademik, pjesë e paketës së instrumentave të cilësisë. Të dhënat e mbledhura nga këto mekanizma janë pjesë e analizës vjetore të njesisë bazë, kryesore dhe të institucionit. Ato shërbejnë ndër të tjera edhe në evidentimin e indikatorëve apo kritereve shtesë që duhen të merren parasysh gjatë shpalljes së vendeve vakante për punësim.

Evidenca:

- Evidenca 1.1-Statuti i WBU;
- Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së;
- Evidenca 4.4-Praktika e punësimit në WBU;
- Evidenca 4.5-Kontrata e punës së personelit akademik;
- Evidenca 2.24-Paketa e instrumentave të cilësisë;
- Vizita në institucion.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

WBU ka 11 laboratorë që janë në funksion të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri, në mesin e laboratorëve që disponon. Për procesin mësimor dhe zhvillimin e orëve laboratorike në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm. Stafi ndihmës akademik akseson, drejton dhe monitoron studentët (pajisja e studentëve me veshjen e nevojshme) gjatë orëve laboratorike por edhe stafin akademik për hulumtime dhe praktika në fushat e tyre të specializimit duke i asistuar ata.

Evidenca:

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullorja e programit Master i Shkencave në Infermieri - Evidenca 1.6-Inventar i laboratorit - Evidenca 4.7-Manualet e Laboratorëve - Vizita në Institucion.
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit (akademik, ndihmës akademik, administrativ) të angazhuar në programin e Studimit Master Shkencor në Infermieri, mblidhen, ruhen dhe përditëson çdo vit akademik nga Zyra e Burimeve Njerëzore ku secili anëtar ka dosjen individuale me dokumentacionin e nevojshëm dhe përkatës për tipin e kontratës, kualifikimet, trajnimet, punimet shkencore etj. Evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër ruhen nga njësia bazë dhe kryesore.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.12-CV-të e personelit akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 4.2-TABELAT; - Evidenca 2.26-Raporti Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë vendas dhe të huaja, me rrjetin e Spitaleve Amerikan dhe Hygea për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët në mjediset e këtyre institucioneve. Programi EPIC është është një nga shembujt e këtij bashkëpunimi, duke instaluar një model të qëndrueshëm për të mbështetur studentët në zhvillimin e praktikës profesionale infermierore. Studentët në praktikën profesionale në mjediset spitalore instruktohen nga drejtues të praktikës që janë pjesë e organikës spitalore. <i>GVJ konstaton se një nga pikat e forta të programit të studimit master Shkencor në Infermieri është angazhimi aktiv i studentëve në praktikën profesionale spitalore.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7- Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU për programet e Departamentit të Infermieri dhe Fizioterapi;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.22-Lista e marrëveshjeve për EPIC; - Evidenca 2.26-Raporti Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Vizita në institucion, takimi me studentët. 			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve të nëshkruara ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve të praktikës. Personeli mbikqyrës i praktikës klinike vlerëson performancën e studentëve në praktikë dhe bashkërendon procesin me stafin akademik përgjegjës për praktikat në WBU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3- Rregullorja e programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.21-Paketa e instrumentave të vlerësimit të Praktikës Profesionale; - Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. 			
Konkluzione	<p>Personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ që mbulon programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, në përgjithësi përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit duke garantuar standardet e mësimdhënies të programit të studimit. Megjithatë, GVJ konstaton se në program është i anagazhuar staf akademik me Master Shkencor, gjë që bie ndesh me standardet e cilësisë së mësimdhënies. Pasi stafi akademik i angazhuar në një program studimi si staf akademik duhet të këtë të paktën një nivel më të lartë edukimi apo kualifikimi se programi i studimit ku është i anagazhuar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	WBU ka siguruar për studentët që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri mjedise të mjaftueshme për

Mert. D.

[Signature]

<p>përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Kampusi i institucionit gjendet në pozicion gjeografik strategjik, i distancuar nga rruga kryesore, me ambient të bollshëm dhe të gjelbër dhe larg zonave me ndotje mbi normat e lejuara. Institucioni plotëson normativën për sipërfaqen e shfrytëzueshme minimale dhe maksimale, respektivisht 3.8-4.0m² dhe 7.5-8.0m². Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se WBU plotëson normativat teknike të ndricimit natyral të ambienteve mësimorë, sallate laboratoreve ishin të ndricuara, me ajrim dhe të pajisura me mjetet e duhura didaktike sipas specifikës. Godinat e WBU përmbushin kushtet higjieno-sanitare si për studentët dhe stafin. <i>Një problematikë e evidentuar ishte dhe përmirësimi i transportit të studentëve nga ana e institucionit, për shkak të largësisë nga zonat e banuara.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.8-Relacion mbi infrastrukturën në WBU; - Vizita në mjediset e institucionit. 												
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me tabela inteligjente (smart boards). Sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorët janë me ndricim natyral dhe të pajisura me sistem ajrimi dhe kondicionimi. WBU në funksion të mësimdhënies disponon laboratorë që janë të shfrytëzueshëm sipas rastit nga studentët e programeve të studimit që ofrohen nga institucioni. Laboratorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike në varësi të specifikës së tyre. Aksesimi i laboratorëve mundësohet nga staf i dedikuar dhe studentët përpara hyrjes në laborator pajisen me veshjet e nevojshme të dedikura për zhvillimin e orëve laboratorike. Në funksion të zhvillimit të orëve laboratorike, studentët kanë dollape personale ku vendosin veshjet dhe sende të tjera personale në kushte sigurie të plotë. Mbetjet laboratorike trajtohen në përputhje me marrëveshjet dhe standardet e vendosura për evadim dhe mbrojtjen e mjedisit. Laboratorët në funksion të mësimdhënies për programin Master Shkencor në Infermieri janë 11 nga 27 në total që institucion disponon, tabela në vijim.</p> <table border="1" data-bbox="598 1590 1420 1883"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Emërtimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Laboratori i Fizioterapisë</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Laboratori i Biologjisë Molekulare dhe Gjenetikës</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Laboratori i Biokimisë dhe Biokimisë Klinike</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore</td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	Emërtimi	1	Laboratori i Fizioterapisë	2	Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale	3	Laboratori i Biologjisë Molekulare dhe Gjenetikës	4	Laboratori i Biokimisë dhe Biokimisë Klinike	5	Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore
Nr.	Emërtimi												
1	Laboratori i Fizioterapisë												
2	Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale												
3	Laboratori i Biologjisë Molekulare dhe Gjenetikës												
4	Laboratori i Biokimisë dhe Biokimisë Klinike												
5	Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore												

	<table border="1"> <tr><td>6</td><td>Laboratori i Fiziologjisë</td></tr> <tr><td>7</td><td>Laboratori i Histopatologjisë</td></tr> <tr><td>8</td><td>Laboratori i Biologjisë Qelizore</td></tr> <tr><td>9</td><td>Laboratori i Anatomisë</td></tr> <tr><td>10</td><td>Laboratori i Mikrobiologjisë</td></tr> <tr><td>11</td><td>Laboratori i VR-it</td></tr> </table>	6	Laboratori i Fiziologjisë	7	Laboratori i Histopatologjisë	8	Laboratori i Biologjisë Qelizore	9	Laboratori i Anatomisë	10	Laboratori i Mikrobiologjisë	11	Laboratori i VR-it
6	Laboratori i Fiziologjisë												
7	Laboratori i Histopatologjisë												
8	Laboratori i Biologjisë Qelizore												
9	Laboratori i Anatomisë												
10	Laboratori i Mikrobiologjisë												
11	Laboratori i VR-it												
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët e WBU janë të pajisura me mjetet e përshtatshme për plotësimin e moduleve të programit Master Shkencor në Infermieri dhe aftësimin teorik e praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Laboratorët janë të pajisur me aparatura të specializuara për praktikën infermierore, pajisje për monitorimin e gjëndjes shëndetësore të pacientit, pajisje për trajtimin e emergjencave shëndetësore etj.</p> <p>Mjediset në funksion të mësimdhënies janë të pajisura me mjetet audiovizive si PC, internet, projektorë, sisteme audio në funksion të mësimdhënies dhe prezantimit të detyrave të kursit apo projekteve të lëndëve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.9-Plan shpërndarja e smart boards nëpër klasa; - Evidenca 4.7-Manualet e Laboratorëve; - Evidenca 4.10-Marrëveshja për evadimin e mbetjeve laboratorike; - Vizita në ambjentet e institucionit, klasa, laboratore etj. <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.11-Të dhëna mbi infrastrukturën e Sallës së Konferencave; - Evidenca 4.12-Kontrata për shërbimime internetit; - Evidenca 1.6-Inventari i laboratorit; - Evidenca 4.13-Lista e asetëve teknologjike të WBU; - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Vizita në mjediset e institucionit. 												
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së</p>	<p>Laboratorët në funksion të mësimdhënies për programin Master Shkencor në Infermieri janë 11 nga 27 në total që WBU disponon. Në mesin e tyre është dhe Laboratori i Shkencave Komjuterike dhe Inteligjencës Artificiale dhe Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore, të pajisur me programe profesionale në përputhje edhe</p>												




<p>programit të studimit që ofron.</p>	<p>me natyrën e programit të studimit Master i Shkencave në Infermieri, tabela në vijim.</p> <p>Nr. Emërtimi</p> <p>1 Laboratori i Fizioterapisë</p> <p>2 Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale</p> <p>3 Laboratori i Biologjisë Molekulare dhe Gjenetikës</p> <p>4 Laboratori i Biokimisë dhe Biokimisë Klinike</p> <p>5 Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore</p> <p>6 Laboratori i Fiziologjisë</p> <p>7 Laboratori i Histopatologjisë</p> <p>8 Laboratori i Biologjisë Qelizore</p> <p>9 Laboratori i Anatomisë</p> <p>10 Laboratori i Mikrobiologjisë</p> <p>11 Laboratori i VR-it</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6-Inventari i laboratorit; - Evidenca 4.7-Manualet e Laboratorëve; - Vizita në institucion, mjediset e laboratorëve.
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>WBU garanton për studentët e programit Master Shkencor në Infermieri mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale. Institucioni ofron kapacitete spitalore dhe ambulatorë në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet partnere si grupi i Spitaleve Amerikane dhe Spitali Hygea. Për përfshirjen e studentëve të programeve të infermierisë në praktika apo intershipe, WBU ka lidhur marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi me grupin e klinikave MEDIAN Reha-Zentrum Bernkastel –Kues në Gjermani. Ky bashkëpunim, si u konstatua nga takimi me studentët dhe stafin ka filluar konkretizimin me vizitën e grupit të parë të studentëve dhe stafit të WBU në Gjermani.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.19-Listat totale dhe tekstet e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU; - Evidenca 4.15-Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital sh.a dhe Shoqërinë International Hospital sh.a;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.16-Paketë e kryerjes së praktikës së studentëve Msc. Infermieri në Spitalin Amerikan; - Evidenca 4.17-Vendim i Bordit të Adimistrimit për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin e studentëve dhe personelit në MEDIAN Reha-Zentrum Bernkastel-Kues; - Evidenca 1.18-Draft marrëveshje me institucione partnere për zhvillimin e intershipeve apo praktikave profesionale (Gjermani dhe Austri); - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët. 								
Konkluzione	<p>WBU disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri. Përveç mjediseve laboratorike që disponon, institucioni në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet partnere si grupi i Spitaleve Amerikane dhe Spitali Hygea mundëson formimin praktik, të posaçme të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>WBU ofron literaturë bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe dhe angleze për studentët e programit Master Shkencor në Infermieri me profile. Biblioteka siguron mundësinë për të përdorur literaturë në formatin fizik dhe elektronik. Qasja e burimeve online të literaturës mundësohet nga faqja web e bibliotekës me akses të dedikuar për studentët e WBU. Burimet e disponueshme për shkencat mjekësore në bibliotekë ishte rreth 8800 vëllime, përfshirë 2800 revista shkencore. Nga vizita në bibliotekë u konstatua se studentët shfrytëzonin si fondin elektronik dhe atë fizik të disponueshëm për programin e studimit. Gjithashtu studentëve u mundësohej edhe literaturë në gjuhën shqipe në formën e ciklit të leksioneve të përgatitur nga lektorët e lëndës.</p> <p>Evidenca:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.19-Dokumenti i abonimit në JSTOR; - Evidenca 4.20-Marrëveshje për akses në Research4Life; - Evidenca 4.21-Rregullorja e Bibliotekës; - Vizita në institucion, takimi me studentët stafin akademik dhe vizita në Bibliotekë.
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile mundësonte përditësimin e vazhdueshëm të literaturës për programin e studimit me botime të viteve të fundit. Raportimet për nevoja të teksteve dhe literaturës shtesë të programit ishin pjesë edhe e projekt- buxhetit vjetor të njësisë nëpërmjet blerjes së librave të reja apo abonimeve online në baza të dhënash ndërkombëtare mjekësore si JSTOR dhe Research4Life. Pasurimi i bibliotekës është pjesë edhe e buxhetit vjetor të institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.19-Dokumenti i abonimit në JSTOR; - Evidenca 4.20-Marrëveshje për akses në Research4Life; - Evidenca 4.22-Lista e librave (Fondi i Bibliotekës); - Evidenca 4.23-Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit; - Vizita në institucion, Biblioteka.
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e WBU është në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri duke ofruar shërbime për përdorimin e literaturës fizike si dhe aksesin në burimet elektronike të literaturës shkencore dhe baza të të dhënave mjekësore ku institucioni ka akses. Mjediset dhe shërbimet e bibliotekës me standarde bashkëkohore janë në dispozicion të studentëve në oraret e miratuara dhe publikuara. Studentët pajisen me kartën e bibliotekës dhe nëpërmjet saj mund të huazojnë tekste fizikisht ose të rezervojnë dhoma studimi për një periudhë kohe të caktuar. Biblioteka mundëson aksesimin falas në burime online të literaturës lidhur me programin e studimit. Guida e Studentit, Manuali dhe Rregullorja e Bibliotekës janë dokumente nëpërmjet të cilave studentët informohen hollësisht për bibliotekën, mundësitë që ofron, oraret e aksesimit, etj. Mundësia e aksesimit falas të studentëve në baza të dhënash të rëndësishme mjekësore si Research4Life dhe JSTOR konsiderohet nga GVJ si shembull i praktikës së mirë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.19-Guida e Studentit;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.21-Rregullorja e Bibliotekës; - Evidenca 4.24-Manuali i Bibliotekës; - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës.
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e WBU ka sipërfaqe 415m², kapacitet 80 poste leximi dhe mundësi depozitimi të rreth 40 000 titujve dhe libra shkencor. Ajo është e pajisur me fond fizik si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse mjekësore, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit Master Shkencor në Infermieri. Aktualisht, biblioteka disponon 25 000 tituj burime fizike me 6 300 prej tyre tashmë të regjistruara. <i>GVJ duke marrë në konsideratë faktin që programi i studimit është relativisht i ri, konstaton se literatura në gjuhën shqipe e lidhur specifikisht me programin dhe profilizimin Infermieror kërkon pasurim të vazhdueshëm.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.22-Lista e librave (Fondi i Bibliotekës) ; - Evidenca 4.25-Raporti i infrastrukturës (kapaciteti i Bibliotekës); - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës.
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>WBU ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë në bibliotekat online për të gjithë studentët. Studentët mund të aksesojnë në këto biblioteka përmes adresës së emailit institucional falas në burime informacione sipas fushës së tyre të interesit. Studentët që ndodhen jashtë perimetrit të rrjetit kompjuterik të WBU mund të aksesojnë në burimet elektronike në opsionin <i>remote</i> pas autentifikimit në Pikën Qëndrore të Regjistrimit. Burimet elektronike përdoren nga studentët për qëllime edukative shkencore duke respektuar ligjin dhe të drejtën e autorit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.24-Manuali i Bibliotekës; - Evidenca 4.19-Dokumenti i abonimit në JSTOR; - Evidenca 4.20-Marrëveshje për akses në Research4Life; - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës.
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Biblioteka e WBU përveç infrastrukturës fizike bashkëkohore, disponon edhe rrjetin kompjuterik dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzim pa kufizim për të gjithë studentët. Studentët nëpërmjet llogarisë personale të dedikuar dhe emailit institucional mund të aksesojnë në literaturën online të interesit.</p>

<p>shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua se në bibliotekë ishin organizuar kënde të përshtatshme studimi të pajisura me kompjuter, tavolinë studimi dhe borde shënimesh për shfrytëzimin nga studentët e të gjitha programeve të studimit si në mënyrë individuale dhe në grup.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 4.13-Lista e asetëve teknologjike të WBU; - Evidenca 4.25- Raporti i infrastrukturës (kapaciteti i Bibliotekës); - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës.
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në Manualin e Bibliotekës, që u vihet në dispozicion të gjithë studentëve të WBU janë të përcaktuara qarta detyrat dhe përgjegjësitë e studentëve si dhe disponueshmëria për tu shfrytëzuar nga studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët është i afishuar në hyrje të saj. Biblioteka është e hapur nga ora 8.30-19.00 dhe në periudhë sezonesh qëndron e hapur edhe në fundjavë. Biblioteka online, në sajë të sistemit të automatizimit mund të aksesohet nga studentët në çdo kohë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.24-Manuali i Bibliotekës; - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës.
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin</p>	<p>Nga vizita në institucion, në mjediset e Bibliotekës, GVJ konstaton se Biblioteka e WBU dokumenton të dhënat lidhur me përdorimin e fondit fizik dhe online nga stafi dhe studentët. Njësitë përgjegjëse për pasurimin dhe përditësimin e fondit fizik dhe online të bibliotekës në lidhje me programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, janë Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Këto dy njësi në projekt –buxhetin vjetor parashikojnë edhe një fond të dedikuar për literaturën online dhe fizike në varësi të analizave dhe kryera për shfrytëzimin e titujve, nevojat që kanë studentët dhe stafi në lidhje me programin e studimit, shkallën e shfrytëzimit të fondit, cilat tituj shfrytëzohen më shumë, online apo fizik, etj.</p> <p>Evidenca:</p>

fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.27-Raport mbi përdorimin e fondit fizik dhe online të Bibliotekës për programin e studimit Master i shkencave në Infermieri; - Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës, takimet me stafin akademik, studentët dhe drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore. 								
Konkluzione	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Infermieri me profilepërmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, kënde leximim, akses falas në burimet online të literaturës etj.). Literatura e aksesueshme si fizike dhe online është në dy gjuhë shqip dhe anglisht, ndërkohë që dominon literatura në gjuhën angleze. Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekën në oraret e afishura në hyrje të saj çdo ditë, ndërkohë që në periushë sezonesh edhe në fundjavë.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th style="width: 25%;">Nuk përmbushet</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="font-size: 1.5em;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon sistem të menaxhimit të informacionit i cili administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. SMART-WBU është sistemi i informimit dhe menaxhimit të institucionit që në bashkëpunim me Zyrën e Sekretarisë Mësimore u mundëson studentëve informacion të plotë rreth procesit akademik dhe administrativ.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin,	<p>Të gjitha njësitë dhe personeli i tyre akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët kanë llogaritë e tyre me emailin personal institucional për të aksesuar ne sistemin e informimit dhe</p>





<p>dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>menaxhimit SMART-WBU. Nëpërmjet këtij sistemi, institucioni administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri. Zyra e Sekretarisë Mësimore menaxhon informacionin e studentëve nga regjistrimi në diplomim, Zyra e Burimeve Njerëzore menaxhon informacionin e personelit të anagazhuar në programin e studimit, punësimet etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Vizita në institucion, takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Sekretarisë Mësimore.
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Secila njësi, anëtarët e personelit dhe studentë e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile kanë akses të dedikuar në informacione e dokumente nëpërmjet llogarisë SMART-WBU. Problemet teknike lidhur me platëformën SMART-WBU adresohen nga Zyra e IT-së.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 2.20-Guida e Stafit; - Evidenca 6.2-Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART-WBU.
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit SMART-WBU ka të integruar platforma që mundësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Gjatë vizitës institucionale, në takimet me stafin akademik dhe studentët u evidentua se në platformë ata shkëmbejnë informacion për programin, ngarkonin detyra kursi, leksione apo materiale të tjera studimi, postim i notave dhe njoftime të ndryshme që kishin lidhje me procesin e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 2.20-Guida e Stafit; - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët. 								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>SMART-WBU, sistemi i menaxhimit të informacionit që WBU disponon garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ. Ky sistem mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese pasi është i aksesueshëm në çdo kohë dhe kudo nga i gjithë stafi dhe studentët e WBU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU. 								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Në faqen zyrtare web të institucionit https://wbu.edu.al/en publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze informacionet që lidhen me programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile https://wbu.edu.al/en/program/msc-in-nursing dhe aktivitete të ndryshme që lidhen me programin e studimit dhe departamentin përkatës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqe zyrtare e WBU. 								
Konkluzione	<p>WBU disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional, SMART-WBU dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. Çdo personel dhe student i WBU ka akses të dedikuar në sistem ndërkohë që përmes faqes zyrtare web, institucioni mundëson aksesin në informacionet dhe aktivitete të ndryshme që lidhen me programin e studimit në gjuhën shqipe dhe angleze.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>WBU, çdo vit përmes propozimeve të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, njësitë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile harton projekt buxhetin dhe planin për mbështetjen financiare të cdo programi studimi, përfshirë programin e studimit që po trajtojmë. Projekt buxheti i programit të studimit është pjesë e projekt buxhetit institucional dhe diskutohet për miratim në mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 4.26-Projekt buxheti institucional.
<p>Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, kontratat e shërbimeve të ndryshme si konsultime profesionale dhe shërbime teknike në shërbim të realizimit të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 4.26-Projekt buxheti institucional.
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>WBU harton raportet financiare në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, brenda afateve të përcaktuara të cilat janë pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit. Raportet financiare publikohen në faqen zyrtare web të Qendrës Kombëtare të Biznesit</p>




	<p>(QKB) dhe arkivohen çdo vit në drejtorinë përkatëse në institucion.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 4.6-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023.
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, konkretisht Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në bazë të nevojave dhe propozimeve të njësisë harton projekt buxhetin i cili më pas kalon për diskutim në njësinë kryesore dhe në nivel institucional për miratim. Pas kalimit të këtyre hallkave, WBU vendos në dispozicion njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile raportin financiar përfundimtar të hartuar sipas legjislacionit në fuqi, afateve të parashikuara dhe kërkesave të njësisë sipas niveleve. Raporti vjetor institucional ku përfshihet dhe buxheti i vitit të kaluar dhe projekt buxheti financiar i paraqitet cdo vit Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.6-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023.
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bordi i Administrimit të WBU, që përfaqëson organin drejtues administrativ më të lartë të institucionit nëpërmjet politikave që harton e ndjek garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të programeve të studimit, përfshirë dhe programin Master Shkencor në Infermieri me profile. Disa nga politikat përfshijnë ofrimin e granteve dhe financim të brendshëm për zhvillimin e programit të studimit, investime infrastrukturore, krijimin e qendrave të specializuara kërkimore-shkencore, etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4-Plani Strategjik 2023-2030; - Evidenca 4.26-Projekt buxheti institucional; - Vizita në institucion, laboratorit digjital i anatomisë.
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master Shkencor në</p>




	<i>Infermieri me profile dhe mbështetjen e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Për këtë institucioni harton raporte financiare që marrin parasysh nevojat e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Këto raporte janë pjesë e raportit vjetor institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me aktet rregullatore, legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe aktet e brendshme të institucionit, WBU harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile. Kriteret e pranimit të kandidatëve në këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, që është dhe njësi përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi në përputhje dhe në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin. Kriteret e pranimit miratohen nga Senati Akademik dhe më pas bëhen publike nga njësi kryesore dhe QSHA. Hartimi i politikave dhe procedurave të programeve të studimit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë kryhet nga Bordet e Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës të ngritura pranë cdo departamenti të WBU. Kandidatët për studentë në këtë program, pas përmbushjes së kriterëve dhe plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, në momentin e regjistrimit, nënshkruajnë me WBU kontratën e shërbimit që shënon dhe fitimin e statusit të studentit në WBU. Për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohet barazia dhe transparenca të parashikuara në

	<p>aktet e brendshme, rregulloren institucionale dhe rregulloren e programit të studimit dhe provimeve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e Njesisë kryesore, Njesisë bazë dhe studentët.
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia, gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi i të gjithë kandidatëve për pranim në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profileështë baza e politikave dhe procedurave nga hyrja në dalje të garantuara nga institucioni. Në programin e studimit mund të pranohen kandidatë shqipëtarë dhe të huaj, kandidatë sipas marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe dhe shtetas shqipëtarë e të huaj që kanë përfunduar një program studimi në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, publik ose jo publik. Nga takimi me studentët u konstatua që në mesin e tyre kishte dhe studentët që ciklin e parë të studimeve nuk e kishin përfunduar në WBU. Të drejtat e studentëve janë pjesë e rregullores themeltare të institucionit përfshirë dhe mosdiskriminimin e tyre pavarësisht përkatësisë fetare, gjinore, bindjeve politike etj. Institucioni disponon edhe infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuar që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Vizita në institucion, takimi me studentët.
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në</p>	<p>WBU përpara çdo viti akademik, nëpërmjet Njesisë Kryesore, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, publikon kriteret e veçanta dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe akteve rregullatore te institucionit.</p>

<p>programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret e përzgjedhjes janë të përcaktuara në Statutin e WBU, në Rregulloren Themeltare të WBU, në Rregulloren për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve dhe rregulloren e programit të studimit dhe propozohen nga njësi bazë, përkatësisht Departamenti i Infermierisë dhe Fiziopterapisë. Të drejtën për tu pranuar në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile e ka cdo kandidat që ka të paktën një diplomë bachelor në infermieri dhe programe të tjera të ngjashme, nga WBU dhe cdo universitet tjetër brenda ose jashtë vendit, publik ose jopublik. Kandidatëve nga universitetet e tjera u njihet diploma dhe programi i studimit sipas rregullores përcaktëse. Çdo kandidat për student në këtë program studimi ka si kusht dhe njohjen e gjuhës angleze. Pas vlerësimit të tyre, lista e kandidatëve miratohet nga Senati Akademik dhe bëhet publike nga njësi bazë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.5-Vendimi për Kriteret e Pranimit në Programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë në Departamentin e Infermierisë dhe Fiziopterapisë; - Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e Njesisë kryesore, Njesisë bazë dhe studentët.
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, përfshirë Masterin Shkencor në Infermieri me profile, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të përcaktuara qartë në Statutin dhe Rregulloren Themeltare të WBU, në Rregulloren për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve dhe në Rregulloren e programit të studimit. Këto kritere janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme publikisht nga të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes web të institucionit https://wbu.edu.al/ dhe gjatë vizitës në institucion. Informacioni për mënyrën e vlerësimit të dijeve, përparimit akademik të gjithë studentëve u mundësohet edhe nëpërmjet syllabusit të lëndëve nga lektorët përkatës që në</p>

	<p>zhvillimin e orës së parë të mësimin. Studentët mund të drejtohen për informacion apo paqartësi edhe te këshilltari akademik, koordinatori i programit dhe drejtuesi i Departamentit të Infermierisë dhe Fiziotherapisë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 5.2-Ditët e Informimit brenda institucionit për studentët-organizimi i aktiviteteve informuese; - Vizita në institucion, takimi me drejtuesen e departamentit të Infermierisë dhe Fiziotherapisë, studentët.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>WBU siguron informimin e studentëve dhe gjithë të interesuarve për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në programin e studimit, dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues nëpërmjet publikimeve në faqen web të institucionit https://wbu.edu.al/, vizitave të të interesuarve në institucion gjatë organizimit të orëve të hapura dhe jo vetëm. Në përmbushje të këtij kriteri, WBU merr pjesë edhe në panairë të ndryshme të organizuara brenda vendit ku kandidatët për studentë informohen mbi ofertën akademike, kriteret për rregjistrim e pranim dhe mundësitë e avantazhet që programi Master i Shkencave në Infermieri ofron për punësim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.5-Vendimi për Kriteret e Pranimit në Programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë në Departamentin e Infermierisë dhe Fiziotherapisë; - Evidenca 5.2-Ditët e Informimit brenda institucionit për studentët-organizimi i aktiviteteve informuese;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.4-Raport mbi veprimtarinë e Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve për vitin akademik 2022-2023; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve.
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në kuadër të përmbushjes së këtij kriteri WBU disponon infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe. Studentët e pakicave rome dhe egjiptiane kanë mundësi të barabarta me studentët e tjerë dhe kuota të dedikura për pranimin në programin e studimit Master i Shkencave në Infermieri me profile. Marrëveshjet e bashkëpunimit, sic është rasti i bashkëpunimit me Perspektivat e Reja, mundësojnë ofrimin e bursave dhe mbështetje financiare për studentët nga zonat e veriut të vendit për të frenuar largimin e tyre jashtë vendit. Kuotat e parashikura për këto target grupe të studentëve bashkë me kriteret e kërkura i përcillen Ministrisë përgjegjëse brenda afateve të parashikuara. Mundësitë për bursa që WBU ofron dhe dokumentacioni i kërkuar janë edhe publikisht të akasesueshme në faqen web të institucionit https://wbu.edu.al/en/scholarships-info.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.6-Vendim për miratimin e kuotaave të pranimit; - Evidenca 5.6-Marrëveshja me Perspektivat e Reja për bursa.
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>WBU, nëpërmjet Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, përgjegjës për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Kriteret për studentët e huaj hartohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të Ministrisë së Arsimit dhe në bazë të një procedure të vecantë të vetë institucionit. Kjo procedurë përfshin kriteret specifike që studentët e huaj duhet të plotësojnë për të</p>




	<p>qënë studentë në programet e studimit që WBU ofron. Ndërkohë që kuotat për studentët ndërkombëtarë janë të kufizuara pasi varen nga miratimi i tyre cdo vit akademik nga Ministria e Arsimit. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen web të institucionit me rubrika të vecanta për studimet master https://wbu.edu.al/en/master-admissions dhe studentët ndërkombëtar https://wbu.edu.al/en/international-admissions.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.5-Vendimi për Kriteret e Pranimit në Programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 2.6-Vendim për miratimin e kuotaave të pranimit; - Evidenca 5.7-Manuali për pranimin e studentëve të huaj; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve.
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka ngritur Zyrën e Bursave pranë Dekanatit të Studentëve. Kjo zyrë promovon mundësinë për bursa studimore për studentët ekselentë, me talente të vecanta, për studentët me nevoja ekonomike dhe ndjekjen e procedurës së akordimit të bursave dhe ecurinë e përparimit akademik të studentëve në vazhdimësi me departamentin përgjegjës për programin e studimit. Bursat e ekselencës, institucionale apo bursa studimi për studentë që vijnë nga zona të vecanta në vend mundësohen edhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU me institucionet partnere. <i>Shembull i kësaj praktike është dhe reduktimi i tarifës së shkollimit prej 50%, të studentëve master që janë të punësuar në një nga institucionet partnere.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 5.8-Rregullore e bursave; - Evidenca 5.6-Marrëveshja me Perspektivat e Reja për bursa; - Evidenca 5.9-Lista e institucioneve akademike partnere; - Vizita në institucion, takimi me studentët. 								
Konkluzione	<p>WBU ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile, të qarta, lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë në faqen web të institucionit dhe jovetëm. Këto politika respektojnë dhe mbështesin studentët e shtresave në nevojë të kategorive të ndryshme me kriteret specifike pranimit dhe mbështetje financiare bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Informacioni i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profil edhe kalimi nga një vit akademik në tjetrin mundësohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, njësia kryesore ku ofrohet programi i studimit. Informacioni u vihet në dispozicion studentëve në mënyra e forma të ndryshme si nëpërmjet rregulloreve të programit të studimit, akteve të tjera rregullatore institucionale, informimit cdo fillim viti akademik nga këshilltari akademik për kriteret e kalimit, numrin e krediteve të duhura për të kaluar nga një vit në tjetrin, faqes web të institucionit dhe Manualit të Studentit. Vlerësimet dhe notat e provimeve duke</p>




	<p>respektuar konfidencialitetin u komunikohen studentëve nga vetë lektorët e lëndëve dhe janë të aksesueshme nga ata në sistemin SMART-WBU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>WBU informon studentët që dëshirojnë të ndjekin ciklin e studimeve Master Shkencor në Infermieri me profile në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme nëpërmjet Rregullores së programit të studimit, Statutit dhe Rregullores Themelore të WBU. Në përmbushje të këtij kriteri, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ngre një komision ad-hoc, i cili pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët mundëson njohjen e plotë ose të pjesëshme të kualifikimeve ose studimeve të mëparshme në varësi të rastit. Informacioni i nevojshëm të gjithë studentëve që dëshirojnë të transferohen në WBU u mudësohet edhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, koordinatori i departamentit, këshilltari akademik, sekretaria mësimore dhe stafi ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 5.11-Rregullorja për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve;





	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e Njësisë kryesore dhe bazë.</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile informohen për kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në forma e mënyra të ndryshme. Në fillim të vitit akademik, në javën e parë të mësimit të cdo semestri lektorët e lëndëve të programit prezantojnë syllabusin ku ndër të tjera informojnë studentët për komponentët e vlerësimit, metodat e vlerësimit të dijeve, provimin, kreditet e lëndës, pikët dhe konvertimin final në notë, kalueshmërinë dhe ankimimin ndaj rezultateve. Në platformën SMART-WBU studentët mund të aksesojnë edhe të gjithë dokumentacionin që ka informacion në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive si Rregullorja Themelore e WBU, Rregullore Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve dhe Guida e Studentit. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve, studentëve u bëhen të ditura edhe nga këshilltari akademik, i cili ndjek mbarëvajtjen e tyre gjatë gjithë periudhës së studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.1-Statuti i WBU;</i> - <i>Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së;</i> - <i>Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve;</i> - <i>Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri;</i> - <i>Evidenca 2.19-Guida e Studentit;</i> - <i>Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU;</i> - <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>WBU informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile përmes mënyrave të ndryshme. Informacioni në lidhje me kriteret e diplomimit disponohet në Rregulloren Themelore të WBU, ku është e përcaktuar qartë se cilat janë detyrimet që cdo student duhet të plotësojë që të pajiset me diplomë. Punimi i Diplomës është një lëndë e vecantë në planin mësimor të programit. Njësia bazë udhëheq dhe ndjek të gjithë procesin që nga momenti i aplikimit për temë, miratimin e temës dhe caktimin e udhëheqësit shkencor.</p>

	<p>WBU ka hartuar dhe miratuar Manualin për punimin e diplomës që u vihet në dispozicion të gjithë studentëve që janë për diplomim. Ky program studimi nuk ka akoma të diplomuar, pasi është në vitin e dytë të hapjes së tij, dhe këtë vit akademik do diplomohen studentët e parë. <i>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët u konstatua se procedura për punimin e diplomës nuk ishte finalizuar ende edhe pse studentët, në bazë të profilit dhe në bashkëpunim me pedagogë të lëndëve të caktuara kishin filluar diskutimet për të përcaktuar tematikën e punimit të diplomës.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 3.4-Manuali për punimine diplomës; - Vizita në institucion, takimi me studentët.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>WBU nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve organizon në mënyrë periodike dhe në fillim të çdo viti akademik takime të hapura. WBU merr pjesë edhe në panairët e ndryshme të edukimit që organizohen brenda dhe jashtë vendit për informimin e të gjithë kandidatëve të interesuar për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve organizon javën orientuese të studentëve të rinj si dhe takime me personalitete të profileve të programit përpara mbylljes së fazës së rregjistrimit. Institucioni ka hartuar dhe disponon udhëzues të posaçëm për informim në lidhje me programin e studimit siç është Guida e studentit, fletëpalosje, katalog dhe materiale të tjera promovuese. Informacioni është i disponueshëm dhe aksesueshëm për të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare web të institucionit https://wbu.edu.al/en/study-programs.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.2-Ditët e informimit brenda institucionit për studentët-organizimi i aktiviteteve informuese; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.4-Raport mbi veprimtarinë e Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve për vitin akademik 2022-2023; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve. 			
Konkluzione	<p>WBU ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në program. Informacioni është pjesë integrale e akteve të brendshme rregullatore të institucionit dhe programit të studimit. Në funksion të diplomimit, WBU ka hartuar dhe Manualin e diplomës, ndërkohë që për informimin e të gjithë kandidatëve të interesuar organizon takime periodike informuese në institucion dhe merr pjesë në panairët e edukimit brenda dhe jashtë vendit. WBU ka hartuar dhe disponon udhëzues të posaçëm për informim në lidhje me programin e studimit (Guida e studentit, fletëpalosje, katalog dhe materiale të tjera promovuese) dhe siguron aksesin e tyre për të gjithë, në faqen zyrtare web të institucionit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e programit Master Shkencor në Infermieri me profile informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë nëpërmjet personave përgjegjës të ngarkuar nga njësi bazë për këtë proces. Këta persona përfshijnë këshilltarin akademik, lektorët e programit dhe koordinatoren e departamentit. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është i disponueshëm në planin mësimor të programit të studimit. Ky plan është i bashkangjitur në Rregulloren e programit Master i Shkencave në Infermieri, Rregulloren Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe




	<p>Provimeve dhe në Rregulloren Themeltare të WBU. Çdo informacion është i disponueshëm dhe i aksesueshëm për të gjithë edhe në faqën zyrtare web të institucionit https://wbu.edu.al/en/program/msc-in-nursing.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.13-Tabela 10 Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10; - Vizita në institucion, takimi me drejtuesen e Departamentit të Infermierisë dhe Fizoterapisë.
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>WBU ka vënë në dispozicion të studentëve të programit Master Shkencor në Infermieri me profile informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese përmes planit mësimor të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve të programit nga lektorët përkatës. Informacioni është i disponueshëm dhe aksesueshëm publikisht në faqen zyrtare web të institucionit https://wbu.edu.al/en/program/msc-in-nursing dhe në platëformën SMART-WBU të aksesueshme nga çdo student.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.13-Tabela 10 Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10; - Evidenca 1.8-Dosja e Syllabuseve të Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU.
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Diplomuarëve (Alumni Office) që është në varësi të Dekanatit Studentor është struktura përgjegjëse që informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Kjo zyrë mundëson gjithashtu lidhjet dhe bashkëpunimet midis WBU dhe institucioneve të tjera publike dhe</p>

	<p>private, kombëtare dhe ndërkombëtare. Informacioni dhe organizimi i eventeve (Career Workshop, Career Fair) që kanë të bëjnë me karrierën e ardhshme të studentëve mundësohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës. Ndërkohë që, Zyra e të Diplomuarëve është ura lidhëse midis WBU dhe Alumni. Kjo zyrë organizon evente të ndryshme si aktivitete, seminare, kongrese që synojnë edukimin në vazhdim dhe këshillim reciprok për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim sa më të mirë në tregun e punës. Në përmbushje të këtij kriteri, me vendim të Senatit Akademik është miratuar pranë çdo departamenti dhe ngritja e Bordeve të Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 5.12-Ngritja e Bordeve të Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës; - Evidenca 1.16-Vendimi i Këshillit të Departamentiot për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve të programit Master Shkencor në Infermieri me profileu vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën. Orari mësimor, cili parapakisht miratohet në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë, përcillet në formë elektronike dhe publikohet në faqen zyrtare web të institucionit, informon studentët mbi ndarjen e lëndëve në leksione, laboratore, seminare, sallat ku do të zhvillohet procesi mësimor dhe praktikat profesionale. Ndryshime të mundshme në orar, studentëve u komunikohen elektronikisht nëpërmjet koordinatorëve të departamenteve. Çdo anëtar i stafit dhe student i WBU është i pajisur me adresën zyrtare institucionale që mundëson komunikimin e brendshëm midis tyre</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit.
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes</p>	<p>WBU disponon sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit, konkretisht platformën SMART-WBU, ku studentët e programit Master Shkencor në Infermieri me</p>




<p>sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>profilemarrin informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e lëndëve, syllabuset, lektorët përgjegjës, vlerësimet, notat, pikët etj si dhe ndërveprojnë me pedagogët e tyre. Aksesimi është i mundur në çdo kohë dhe kudo, dhe çdo student është i pajisur me adresën e tij personale institucionale. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me programin e studimit mund të aksesohen dhe në faqen web zyrtare të institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU u siguron studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Në funksion të kësaj, institucioni ka ngritur struktura dhe ka hartuar e miratuar udhëzues të posaçëm që u vihen në dispozicion studentëve nga persona përgjegjës të caktuar për këtë proces. WBU disponon sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit, SMART-WBU, i aksesueshëm nga cdo anëtar staf dhe student, kudo dhe në çdo kohë nëpërmjet adresës institucionale. Sistemi siguron jo vetëm informacion në lidhje me organizimin dhe infrastrukturën e procesit mësimor, por shërben edhe si një platformë ndërveprimi dhe shkëmbimi të informacionit midis studentëve dhe stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të</p>	<p>WBU disponon infrastrukturën e nevojshme për mbajtjen e statistikave vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. Aktualisht të dhënat për programin e studimit janë të disponueshme për studentët në hyrje në Zyrën e Protokollit dhe Korrespondencës,</p>




<p>diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>ndërkohë që ky arkiv do të përditësohet me të dhënat cilësore të studentëve në dalje, pasi të diplomohet brezi i parë i programit të studimit, në fund të këtij viti akademik. Statistika të detajuara në bazë të profileve të programit të studimit ruhen edhe nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Zyra e të Diplomuarve ndjek studentët në prag diplomimi dhe pas diplomimit të tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 5.10-Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve; - Vizita në institucion, takim me përfaqësues të Zyrës së Protokollit dhe Korrespondencës, dhe Zyra e të Diplomuarve.
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Këto statistika menaxhohen nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, përgjegjës për programin e studimit dhe sekretaria mësimore. Rregjistrat themelohet kishin informacion të detajuar për arritjet akademike të çdo studenti, si dhe numrin e studentëve sipas profileve. Nga vizita në institucion u evidentua se një student ishte larguar nga programi i studimit. Rezultatet e statistikave që lidhen me studentët janë pjesë e raporteve vjetore të departamentit dhe institucionit. Ato arkivohen në Zyrën e Protokollit dhe Korrespondencës.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 kemi 5 studentë (gjuhë angleze) të regjistruar, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 kemi 10 studentë (6 studentë në gjuhën shqipe dhe 4 në gjuhën angleze).</p> <p>Evidenca:</p> <p>Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; Evidenca 5.5-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore; Evidenca 2.26-Raporti vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë; Evidenca 5.10-Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve; Vizita në institucion, Sekretaria Mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes</p>	<p>WBU menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes sistemit të brendshëm të informacionit, SMART-WBU në kushte sigurie të lartë dhe të aksesueshëm vetëm nga persona përkatës të</p>

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>autorizuar. Zyra e Sekretarisë mësimore është struktura përgjegjëse për menaxhimin e brendshëm të informacionit që lidhet me studentët si rregullimi, monitorimi dhe arkivimi i cdo regjistrimi, informacioni apo transkripti lidhur me studentët. Ruajta e të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, akteve rregullatore të brendshme institucionale duke respektuar konfidencialitetin.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 5.5-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU.
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>WBU mbështet me akte, pranë gjithë njësive përgjegjëse kontrollin periodik për menaxhimin e informacionit si sekretarinë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Institucioni gjithashtu vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse përmes auditimit periodik të brendshëm. Çdo kontroll periodik shoqërohet me një raport që u vihet në dispozicion njësive drejtuese të institucionit për vlerësim të situatës dhe marrjen e masave për përmirësim në rast problematikash apo mangësish të evidentuara.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 5.3-Raporti i Auditimit Administrativ.
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është njësia bazë përgjegjëse për hartimin e raporteve analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe mbajtjen e statistikave mbi ecurinë e studentëve gjatë ciklit akademik. Zyra e Diplomimit ndjek ecurinë e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, ndërkohë që ecuria e studentëve në programin e studimit menaxhohet nga Sekretaria Mësimore. Konkretisht për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile</p>

përmirësimin të këtyre treguesve.	<p>nuk ka raport analitik të plotë, të hollësishëm, përfundimtar, pasi brezi i parë i studentëve që ndjekin këtë program studimi diplomohet këtë vit akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 1.14-Rregullore mbi Organizimin Akademik. 			
Konkluzione	<p>WBU mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Për këtë ka ngritur struktura të caktuara dhe kryen kontrolle periodike përmes auditimit të brendshëm. Të dhënat paraqiten në raporte që u vihen në dispozicion njëjësive drejtuese të institucionit dhe në bazë të tyre hartohen dhe plane masash për adresim të problematikave të evidentuara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	WBU në rregulloret dhe aktet e brendshme normative parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik, pjesë e NJSBC dhe pjesë e GVB gjatë akreditimeve institucionale dhe të programeve. Studentët e programit Master Shkencor në Infermieri me profile marrin pjesë në mbledhjet e departamentit, janë pjesë e grupeve të punës që kanë të bëjnë me cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit në përgjithësi. Shembulli konkret është pjesëmarrja e tyre në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programit të studimit. Zyra e Koordinimit të Klubeve Studentore mbështet studentët në organizimin e aktiviteteve të ndryshme akademike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive.

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 2.27-Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës Senatorin e programit të studimit në Njësinë Bazë; - Evidenca 5.1-Vendimi i Senatit Akademik për ngritjen e GVB; - Vizita në institucion, takimi me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm.
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>WBU garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, përfshirë dhe studentët e programit Master Shkencor në Infermieri. Përfshirja është konkrete dhe reale, studentëve u dërgohen ftesa në lidhje me takimet ku janë të ftuar të marrin pjesë dhe informacion mbi orarin, sallën, tematikën, etj. Shembull konkret është dhe përfshirja në grupin e punës për akreditimin e programit edhe studentëve. Matja e rezultateve mundësohet nëpërmjet pyetësorëve periodik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.27-Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës Senatorin e programit të studimit në Njësinë Bazë; - Vizita në institucion, takimi me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm.
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile, përfshin në mënyrë aktive studentët në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri, kjo njësi përfshin në mënyrë aktive studentët në mbledhjet e hapura që organizon. Opinonet dhe mendimet e studentëve merren parasysh edhe nëpërmjet organizimit të pyetësorëve që organizohen dy herë në vit, në fund të cdo semestri. Rezultatet e pyetësorëve u bëhen të ditura jo vetëm strukturave drejtuese dhe njësive përgjegjëse për programin por edhe studentëve. Këto rezultate shërbejnë edhe për marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 2.27-Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës Senatorin e programit të studimit në Njësinë Bazë; - Vizita në institucion, takimi me studentët. 			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve të programit Master Shkencor në Infermieri me profile u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në respekt të konfidencialitetit, studentëve u komunikohen rezultatet e provimit direkt nga lektori i lëndës si dhe ngarkimi i tyre në platformën elektronike SMART-WBU. Studentët kanë të drejtën e ankimimit, në rast se nuk janë dakort me rezultatin. Kjo e drejtë e studentëve është pjesë e rregulloreve të brendshme të institucionit dhe të programit të studimit. Në rast ankimimi studenti duhet që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesi me shkrim ne Zyrën e Sekretarisë Mësimore kërkesën për ankimim. Departamenti përkatës, ngre një komision ad-hoc i cili merret me shqyrtimin e ankesës dhe përbëhet nga tre anëtarë, ku pedagogu i lëndës nuk lejohet të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i komisionit i komunikohet studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së ankimimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 2.1-Rregullorja Për Studimet e Ciklit të Dytë dhe Provimeve; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU përfshin dhe angazhon studentët e programit Master Shkencor në Infermieri me profilenë organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Shembuj konkret janë pyetësorët e studentëve dhe pjesëmarrja e tyre në mbledhje të hapura të departamentit dhe në grupet e punës për akreditimin e programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi V.6
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore, Dekanati Studentor dhe zyrat që kanë nën varësi janë njësi të posaçme të WBU në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, përfshirë dhe studentët e programit studimit që po vlerësojmë. Edhe departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë me personelin përkatës (lektorët e lëndëve, koordinatori i programit, këshilltari akademik) është në shërbim të informimit të studentëve. Studentët informohen në kohë reale me informacion të përditësuar edhe përmes faqes zyrtare web të institucionit dhe platformës SMART-WBU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 1.14-Rregullore mbi Organizimin Akademik; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Këshilltari akademik, drejtuesi i departamentit dhe lektorët e lëndëve përkatëse këshillojnë studentët në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Dekanati Studentor, Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyra e Planifikimit të Karrierës mbështesin studentët në orientimin e tyre për procesin mësimor, jetën studentore dhe aktivitete që kanë lidhje me programin e studimit, brenda dhe jashtë universitetit. Platforma SMART-WBU dhe faqja zyrtare web e institucionit janë burime të vlefshme të informacionit për studentët pasi mund të aksesohen në cdo kohë dhe kudo. Në dispozicion të gjithë të interesuarëve për informacion, është e disponueshme dhe adresa e dedikur e emailit info@WBU.edu.al.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 1.14-Rregullore mbi Organizimin Akademik; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit;

	- Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Studentëve të Masterit Shkencor në Infermieri u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Diplomuarëve (Alumni). Studentët mund ti drejtohen kësaj zyre vazhdimisht dhe sa herë e kanë të nevojshme për tu informuar në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin e praktikës profesionale dhe tregut të punës. Zyra organizon aktivitete të formave dhe me tematika të ndryshme të edukimit në vazhdim ku studentët janë pjesëmarrës aktiv bashkë me pedagogët e tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Diplomuarëve (Alumni) dhe studentët. 			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Diplomuarëve (Alumni) në WBU ndjek studentët e diplomuar dhe mbledh të dhëna për punësimin e tyre që u vihen në dispozicion studentëve dhe njësive të ndryshme të institucionit. Për Programin e Studimit Master Shkencor në Infermieri me profilekjo zyrë nuk disponon informacion për të diplomuarit pasi akoma nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.13-Rregullore mbi Organizimin Administrativ; - Evidenca 2.19-Guida e Studentit. 			
Konkluzione	<i>WBU ka hartuar procedura e ka krijuar njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët e të gjitha programeve të studimit, përfshirë studentët e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>WBU u kushton rëndësi hartimit dhe zbatimit në nivel institucional të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në përputhje me fushën e studimeve. Në përmbushje të këtij kriteri në Rregulloren Themeltare të Universitetit Western Balkans, Neni 75, pikat 4-6, Rregulloren Për programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë dhe në Rregulloren e Programit Master i Shkencave në Infermieri me profile, Neni 6, janë përcaktuar format e mësimdhënies që lidhen me procesin mësimor. Këto forma përfshijnë leksionet, punët laboratorike, praktikat mësimore, vizitat studimore në terren apo laboratore të ndryshme, seminarët, testet e shkurtra, punët individuale si detyra kursi e projekte dhe punime të tjera të ngjashme të parashikura në modulet e ndryshme të programit mësimor, të cilat janë të aplikueshme nga i gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion, në takimet me stafin akademik dhe studentët u konstatua se mësimdhënia zhvillohej në mënyrë interaktive duke kombinuar aspektin teorik me prezantim e diskutim të rasteve klinike nga praktika, ndërkohë që infrastruktura e institucionit mundësonte zbatimin e cdo forme inovative të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullore Programit të Studimi Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 1.8-Dosja e Syllabuseve të programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 6.2-Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART-WBU;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.14-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU; - Vizita dhe takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Bazuar në Nenin 15 të Rregullores Themeltare të WBU, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është njësi përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e mekanizmave më cilësor të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies. Kjo njësi ka rregulloren e vetë të funksionit të miratuar nga Senati Akademik, ndërkohë që Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit është struktura tjetër që bashkëpunon dhe bashkëvepron ngushtë me NJSBC në nivel institucional për hartimin dhe zbatimin e mekanizmave më cilësor të monitorimit të cilësisë dhe metodave inovative të mësimdhënies, monitorimin periodik të performancës së stafit akademik dhe vlerësimin e programit të studimit nëpërmjet instrumentave të cilësisë të hartuar dhe miratuar (paketa e instrumentave të Cilësisë). NJSBC në bazë të rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve periodike të mësimdhënies harton raporte vjetore me rekomandimet përkatëse që janë publike. Për përmbushjen e rekomandimeve, hartohet dhe një plan aktivitetesh vjetor që organizohen nga strukturat akademike dhe ndihmës akademike të institucionit si trajnime për mësimdhënien. Çdo sugjerim apo ndryshim që është rezultat i diskutimeve të kryera në kuadër të këtyre aktiviteteve që lidhen specifikisht me programin e studimit diskutohen në mbledhjen e njësisë bazë dhe janë pjesë e analizës vjetore të njësisë. Ndërkohë që, Senati Akademik i institucionit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.3-Vendimi për ngritjen e NJSBC; - Evidenca 6.4-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; - Evidenca 6.5-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 6.6-Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 6.14-Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC; - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi vjetor; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC.
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në WBU, studentët janë të përfshirë aktivisht në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Pjesë e vlerësimit janë studentët që ndjekin aktualisht programin e studimit, studentët që diplomohen dhe ata të diplomuar. Vlerësimi kryhet nëpërmjet pyetësorëve që përmbajnë pyetje të hapura dhe të mbyllura, që organizohen në fund të cdo semestri për cdo lëndë dhe staf akademik, ku vlerësohet njëkohësisht performanca e stafit dhe përmbajtja e lëndës. Të dhënat e pyetësorit të studentit u vihen në dispozicion njësive bazë dhe përgjegjëse me qëllim hartimin e planit të masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies bazuar në sugjerimet e bëra. Bazuar në Rregulloren Themeltare të WBU, Neni 99 dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Infermieri, Neni 17, studentët kanë të drejtën e ankimimit dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore Themeltare WBU-së; - Evidenca 1.3-Rregullorja e Programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 2.28-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC dhe studentët.
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në WBU, në faqen web të institucionit ka një rubrikë të dedikuar për informim në lidhje me politikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional. Në këtë rubrikë publikohen në mënyrë periodike raportet vjetore të hartuara nga NJSBC të cilat janë publike për studentët, stafin dhe gjithë të interesuarit. Raportet vjetore i vihen në dispozicion njësive bazë për të hartuar planin e masave për ndryshime apo përmirësime në programin e studimit, bazuar në rekomandimet e bëra.</p> <p>Evidenca:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.6- Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 6.7-Rasti i planit të masave të ndërmmara nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC; - Evidenca 6.8. Rasti i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC.
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika të qarta për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe rekomandimet e raporteve vjetore të NJSBC. Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka hartuar Guidën e Stafit, që i vihet në dispozicion stafit akademik dhe shërben si orientues për veprimtarinë e tyre, promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxitje për përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies. Mekanizëm tjetër i vlerësimit të rezultateve të marra është dhe Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit. Në bazë të Nenit 17, të kësaj rregulloreje, stafi akademik me performancën më të lartë brenda njëjësive bazë dhe kryesore përzgjidhet për promovim akademik. Stafi akademik ka mbështetje të plotë financiare në lidhje me aktivitetin kërkimor shkencor si publikim artikujsh apo pjesëmarrje në konferenca. Udhëzimi për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor ka përcaktuar dhe listën e dokumentacionit përkatës që duhet të dorëzohet bashkë me kërkesën për rimbursim nga fondi i rimbursimit. <i>Në fillim të cdo viti akademik, institucioni ka si praktikë të mirë zhvillimin e ditëve orientuese të stafit , përfshirë stafin akademik, ndihmësakademik dhe administrative.</i> Çdo anëtar i stafit njihet me të drejtat, përgjegjësitë, detyrat, si dhe organizimin dhe funksionimin e institucionit si dhe objektivat për vitin e ri akademik. Gjithashtu, WBU mbështet stafin akademik dhe kërkimor për kualifikime të mëtejshme si studime doktorale, apo pjesëmarrje në projekte nëpërmjet asistencës së vazhdueshme në procesin, procedurat dhe materialet për aplikim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1- Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9-Praktikë e pjesëmarrjes së personelit në konferencë brenda apo jashtë vendit; - Evidenca 2.20-Guida e stafit; - Evidenca 6.10-Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC. 								
Konkluzione	<p>WBU ka ngritura struktura përgjegjëse (NJSBC) dhe të tjera mekanizma për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përfshirë dhe cilësinë e mësimdhënies. Studentët e të gjitha niveleve janë pjesë aktive e vlerësimit nëpërmjet pyetësorit të studentit. Stafit akademik dhe kërkimor ka mbështetje institucionale dhe financiare për promovim dhe kualifikim të vazhdueshëm. Miratimi i Paketës së Instrumentave të Cilësisë dhe Guida e stafit konsiderohen nga GVJ si shembuj të praktikës së mirë. Bazuar Bazuar në gjetjet e evidentuara si dhe nga vizita dhe takimet në institucion, GVJ mendon se ky standard përmbushet Plotësisht.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>WBU ka ngritur struktura dhe ka hartur politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet rregullatore institucionale. Në përmbushje të këtij kriteri në WBU funksionon NJSBC dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, organ përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Çdo politikë apo akt para se të filloi zbatimin merr miratim në Senatin Akademik. NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë, dhe në përbërjen e saj ka 5 anëtarë, një përfaqësues për çdo fakultet, një përfaqësues të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. Veprimtaria e NJSBC është e parashikuar në statutin e WBU, Neni 37 dhe në rregulloren dhe funksionimin e NJSBC. Të dyja strukturat koordinojnë dhe bashkërendojnë punën me njëra - tjetrën në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të standarteve të cilësisë në nivel institucional dhe programesh mësimore.</p>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.6- Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 6.11-Emërimi i studentit në NJSBC; - Evidenca 6.12-Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është pjesë e politikave dhe Planit Strategjik 2023-2030 të institucionit. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë garantohet në sajë të bashkërendimit të punës së NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit. NJSBC kryen vlerësime periodike të performancës akademike dhe vlerëson programin e studimit nëpërmjet paketës së instrumentave të cilësisë me pjesëmarrjen aktive të studentëve përfshirë studentët që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Infermieri me profile, njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, njësinë kryesore, anaëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik, dhe administrativ. Gjithashtu, pjesë e vlerësimit është dhe eksperti i jashtëm që është pjesë e organikës së NJSBC. Në përfundim të vlerësimit, rezultatet organizohen në raporte, që janë publike dhe u vihen në dispozicion të gjitha njësive të institucionit. Gjithashtu, institucioni organizon dhe aktivitete vjetore sipas një plani të miratuar paraprakisht bazuar në rekomandimet e bëra nga analiza e vlerësimeve të NJSBC. Studentët, përveç pjesëmarrjes në pyetësor kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë edhe nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga Dekanati i Studentëve dhe Këshilli Studentor apo Klubi i Studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 2.27-Praktikë mbledhje me pjesëmarrës Senatorin e programit të studimit në Njësinë Bazë; - Evidenca 6.12-Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Evidenca 1.9-Organizimi i grupeve kërkimore brenda njësive bazë; - Evidenca 2.22-Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit;




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.14-Lista e aktiviteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC; - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor; - Evidenca 6.8-Rast i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC dhe drejtuesin e njësisë bazë.
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>WBU ka hartuar Paketën e instrumentave të cilësisë bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet Europiane të cilësisë. Kjo paketë përfshin instrumenta të qartë vlerësimi, të matshëm në mësimdhënie, kërkim shkencor, burime njerëzore, financiare, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, ndërkombëtare dhe aktiviteve social kulturore që përdoren për vlerësimin periodik si semestral dhe vjetor. Sigurimi i jashtëm i cilësisë sigurohet nëpërmjet akreditimit të jashtëm institucional si dhe akreditimit të programit të studimit pavarësisht se institucioni dhe programi i studimit janë hapur rishtazi. Raportet vjetore nga vlerësimi e pyetësorëve u vihen në dispozicion njëjësive përkatëse bashkë me rekomandimet e nxjerra nga ky proces, të cilat janë transparente dhe publike.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 2.10-VKM për hapjen e WBU; - Evidenca 2.11-Urdhër i hapjes së programit Master i Shkencave në Infermieri; - Evidenca 6.14-Lista e aktiviteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC.
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi periodik i performancës së stafit akademik, cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor realizohet nëpërmjet NJSBC. Vlerësimi kryhet nëpërmjet pyetësorit të studentit (2 herë në vit bazuar sipas kuadrit ligjor në fuqi), që vlerëson performancën pedagogut, vlerësimin nga kolegu, vlerësimin nga përgjegjësi i departamentit dhe përmes procedurës së vetëvlerësimit të performancës që janë pjesë e paketës së instrumentave të cilësisë të miratuar. Drejtuesi i departamentit vlerësohet nga stafi akademik dhe dekani. Skeda e vlerësimit individual të secilit anëtar të stafit i vihet në dispozicion në zarf të mbyllur. Të dhënat e vlerësimeve nga instrumentat e paketës së cilësisë janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore, përfshirë dhe rekomandimet</p>




	<p>përkatëse. Në bazë të treguesve të performancës dhe cilësisë, për arritjet më të mira, institucioni kryen promovime nxitëse si në aspektin akademik dhe financiar. Shembull i kësaj praktike është dhe hartimi i Udhëzimit për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor për mbështetje institucionale në rast të publikimve dhe pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore shkencore pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës në departament nga na e stafit akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.28-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik; - Evidenca 6.15-Formular i vetëvlerësimit të stafit; - Evidenca 4.1-Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit; - Evidenca 6.10-Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor; - Evidenca 6.1-Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 202-2023 dhe planifikimi i ri vjetor; - Evidenca 2.8-Mbështetja financiare, bursat, nga partnerët për studentët master; - Vizita në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët. 								
Konkluzione	<p>WBU ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Infermieri me profile në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes krijimit të strukturave përgjegjëse sic është NJSBC, por edhe të hartimit dhe zbatimit të treguesve të qartë të matshëm të vlerësimit të cilësisë sin ë aspektin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në bazë të velrësimeve institucioni harton raportet e rezultateve me rekomandimet përkatëse të cilat shërbejnë edhe si indikatorë për vlerësimin e stafit.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="584 1462 783 1541">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="783 1462 997 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="997 1462 1212 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1212 1462 1436 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="584 1541 783 1585"></td> <td data-bbox="783 1541 997 1585"></td> <td data-bbox="997 1541 1212 1585"></td> <td data-bbox="1212 1541 1436 1585" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>WBU nëpërmjet strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë sic është NJSBC dhe përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit ka hartuar dhe përdor procese formale të dokumentuara për shqyrtimin miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile. Vlerësimi i performancës së pedagogut nga studentët, vlerësimi i programit të studimit nga studentët që diplomohen dhe të diplomuar, vlerësimi i kolegut nga kolegu, vetëvlerësimi i performancës së stafit akademik, vlerësimi i performancës së personelit akademik nga drejtuesi i deparatamentit janë disa nga mekanizmat formal që institucioni përdor për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë. Në fund të çdo vlerësimi harohet një raport në të cilin evidentohen pikat e forta dhe të dobëta. Raporti u vëhet në dispozicion njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, të cilat në bazë të arritjeve apo dobësive hartojnë planin e masave për përmirësim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.22-Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen; - Evidenca 2.24-Paketa e Instrumentave të cilësisë; - Evidenca 6.15-Formular i vetëvlerësimit të stafit; - Evidenca 4.6-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023; - Evidenca 1.26-Raporti i vlerësimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023.
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të komponentëve të cilësisë që janë pjesë e paketës së cilësisë përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri. Këto raporte shërbejnë edhe për promovimin e arritjeve më të mira të stafit akademik, kërkimor shkencor dhe studentëve të angazhuar në programin e studimit. Në bazë të këtyre rezultateve stafi akademik ngrihet në detyrë, mbështetët për organizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore. Studentët me arritje më të larta në procesin mësimor promovohen dhe mbështeten nëpërmjet aplikimit të bursave në bashkëpunim dhe me institucionet partnere. Dokumentimi i rezultateve kryhet në formën e raporteve semestrale</p>

	<p>dhe vjetore të NJSBC të cilat u vihen në dispozicion të gjitha strukturave akademike dhe administrative të institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.15-Formular i vetëvlerësimit të stafit; - Evidenca 2.28-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik; - Evidenca 4.1-Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të zyrës së NJSBC, stafin akademikë dhe studentët.
<p>Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>WBU në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile përdor metoda të drejtpërdrejta (paketa e instrumentave të cilësisë) dhe vlerësime paralele të detyrave të studentëve, provimeve, vëzhgime në auditor gjatë mësimdhënies të cilat janë pjesë përbërëse e pyetësorit për vlerësimin e performancës së stafit akademik të angazhuar në programin e studimit nga studentët gjatë gjithë vitit akademik. Vlerësimi i studentëve për performancën e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit dhe lëndët e programit të studimit kryhet në mënyrë anonime nëpërmjet platformës SMART-WBU, dy herë në vit, një herë në cdo semestër. Vlerësimi individual i cdo stafi akademik i vihet në dispozicion në zarf të mbyllur pas përfundimit të sezonit të provimeve dhe shpalljes përfundimtare të rezultateve. Çdo vlerësim dokumentohet në raport që i vendoset në dispozicion stafit akademik dhe publikohet.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24-Paketa e instrumentave të cilësisë; - Evidenca 2.28-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik.
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni),</p>	<p>WBU në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile përdor edhe instrumenta të tërthortë vlerësimi. Shembulli më i mirë i këtyre metodave është pyetësori i vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen, i cili është hartuar por nuk implementuar akoma pasi në këtë program studimi nuk ka akoma të diplomuar pasi programi është në vitin e dytë të veprimtarisë dhe studentët e parë do të diplomohen këtë vit. Ndryshimet e programit të studimit që janë rrjedhojë e vlerësimeve miratohen nga njësia kryesore dhe Senati</p>

<p>të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Akademik. Jo vetëm kjo, por edhe metodat e tjera vlerësuese të tërthorta do të implementohen më konkretisht në momentin që do të kemi të diplomuarit e parë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.22-Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC në mënyrë periodike programin e studimit Mater Shkencor në Infermieri, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira të studentëve dhe stafit akademik dhe kërkimor shkencor, dhe harton planin e masave për përmirësim nëpërmjet raporteve publike të vlerësimit të cilat u vihen në dispozicion njësisive bazë dhe kryesore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Angazhimi i aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për vlerësimin e cilësisë janë siguruar nga krijimi i strukturave përkatëse të sigurimit të cilësisë si NJSBC, Komisioni i Përhershëm për Granatimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm. Në këtë proces ka përfaqësues nga stafi akademik dhe studentët, si dhe një ekspert të jashtëm. NJSBC dhe organet e tjera përgjegjëse të sigurimit të cilësisë funksionojnë në bazë të rregullorve respektive të miratuara.</p> <p>Evidenca:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.6-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 6.12-Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>WBU nëpërmjet Komisionit të Përhershëm për Granatimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit harton politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë edhe për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile. NJSBC është struktura përgjegjëse për ushtrimin dhe implementimin e politikave, të cilat miratohen paraprakisht nga Senati Akademik. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktorë janë të qarta dhe të parashikuara në aktet rregullatore institucionale të lartpërmendura.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2-Rregullore themeltare e WBU-së; - Evidenca 6.5- Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 6.6-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit; - Evidenca 6.3-Vendimi për ngritjen e NJSBC.
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile, respektivisht Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë janë të përfshirë aktivisht në sigurimin dhe garantimin e cilësisë së këtij programi. Pjesëmarrja aktive garantohet nga përfshirja e stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve që ndjekin programin e studimit. Çdo vlerësim i cilësisë që është pjesë e paketës së instrumentave të cilësisë të hartuar nga NJSBC dhe miratuar nga Senati Akademik përmbledhet në raportet periodike të vlerësimit të cilat diskutohen në mbledhjet e njësisë bazë dhe kryesore me qëllim arritjen e objektivave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24 -Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 6.15-Formular i vetëvlerësimit të stafit;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.27-Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës Senatorin e programit të studimit në Njësinë Bazë; - Evidenca 1.26-Raporti i vlerësimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023. 			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm sigurohet nëpërmjet raportimve periodike dhe vjetore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, konkretisht Departamentin e Infermierisë dhe njësisë kryesore një herë në vit. Procesi kryhet në respekt të integritetit akademik dhe shmangies të cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve nëpërmjet pyetësorëve anonim, dhe ndarjes së rezultateve të stafi akademik duke respektuar konfidencialitetin.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.24 -Paketa e Instrumentave të Cilësisë; - Evidenca 6.15-Formular i vetëvlerësimit të stafit. 			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>NJSBC, struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në përberje të saj ka përfaqësues nga cdo njësi kryesore, përfaqësues të studentëve dhe eksperte të jashtëm duke i bërë ata pjesë aktive të procesit nëpërmjet dhënies së ekspertizës të vlefshme për programin e studimit. Përveç angazhimit të ekspertëve të jashtëm, për garantimin e cilësisë së programit të studimit, institucioni angazhon aktivisht edhe bashkëpunëtorë të jashtëm vecanërisht për dhënien e ekspertizës në hartimin e kurrikulave, shqyrtimit të literaturës apo propozime për përmirësimin dhe hapjen e programeve të reja të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.1-Raport mbi propozimin për hapje të programeve të reja; - Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC dhe ekspertin e jashtëm të cilësisë. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>WBU në proceset e SBC-së të programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile përfshin njësitë akademike (Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentin e Infermierisë), personelin akademik e studentët, ekspertë dhe bashkëpunëtor të jashtëm. Në respekt të konfidencialitetit dhe barazisë, institucioni informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>WBU, në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e mbështet veprimtarinë e tij për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile në Planin Strategjik të Zhvillimit 2023-2030. Ky plan është transparent për stafin akademik, administrativ, studentët dhe të gjithë të interesuarit. Politikat e hartura dhe miratuara në kuadër të SBC-së janë transparente, publike dhe monitorohen vazhdimisht nga organet përkatëse. Në bazë të vlerësimeve hartohen raporte të cilat bëhen pjesë e raporteve vjetore të njësisë bazë përgjegjëse për programe studimit, përfshirë dhe masat e sugjeruara për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore themeltare WBU-së; - Evidenca 2.26-Raport Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë.
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit kryhet në respekt të konfidencialitetit, barazisë pa çënuar lirinë akademike, etikën akademike dhe profesionale dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, Statutin dhe rregulloren e WBU. Pyetësorët e studentëve janë anonime ndërkohë që vlerësimet e stafit i jepen cdo anëtarit në një zarf të mbyllur. Të dhënat e vlerësimit të cilësisë përpunohen në formën e një raporti që i vihet në dispozicion stafit, studentëve dhe strukturave përkatëse përgjegjëse. Ky raport publikohet edhe në faqen Web të institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 1.2-Rregullore themeltare WBU-së; - Evidenca 6.13-Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;

	<p>- Evidenca 6.16-Kodi i Etikës për Stafin Akademik dhe Administrativ WBU.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporet e vlerësimit të cilësisë të cilat hartohen nga NJSBC janë pjesë e raporteve vjetore të njësisë bazë, kryesore dhe strukturave drejtuese akademike dhe administrative të institucionit. Raportet përvec rezultateve të vlerësimit përfshijnë pikat e forta dhe të dobëta si dhe një plan masash të sugjeruar për adresimin e tyre dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Në kuadër të planit të masave WBU organizon aktivitete të ndryshme që përfshijnë trajnime për metoda inovative të mësimdhënies, kualifikime të vazhdueshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik në fushën e kërkimit shkencor, trajnime për njohjen dhe përdorimin e teknikave inovative në mësimdhënie si tabelat SMART, sistemin SMART-WBU, etj. Në vizitën institucionale, stafi akademik dhe ndihmës akademik pohoi që ishte pjesë aktive e këtyre trajnimeve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvillura për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor; - Evidenca 6.2-Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART-WBU; - Evidenca 4.14-Udhëzuesi i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU; - Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe ndihmës akademik.
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i efektivitetit dhe ndikimit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Infermieri me profile është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik në WBU. Në kuadër të këtij procesi, institucioni në fillim të cdo viti akademik organizon ditët orientuese të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ me synim lehtësimin e integritet të tyre në punën dhe objektivat e institucionit. Ditët orientuese kanë një agjendë e cila është hartuar paraprakisht bashkë me personat përgjegjës të caktuar për të koordinuar procesin.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.18-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien.
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari</p>	<p>WBU organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për këtë qëllim. Shembuj të këtyre veprimtarive periodike</p>

<p>periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>përfshijnë pyetëtorin për nevojat për trajnim të stafit në fillim të vitit akademik, plani i zhvillimit të trajnimeve me ekspertë të huaj e vendas me tematikat e sugjeruara, takimet periodike në mbledhjet e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe takimet e studentëve me këshilltarin akademik. Këto takime ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimin të stafit dhe studentëve në lidhje me rolin që gjithsecili ka në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit ku janë të angazhuar.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1-Statuti i WBU; - Evidenca 3.1-Lista e trajnimeve të zhvilluara për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri me profile janë publike, transparente dhe efektive. Nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimeve ku evidentohen pikat e forta dhe të dobëta, si dhe hartimi i planit të masave për adresim të tyre, institucioni ka hedhur bazat e krijimit të Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Procesi i sigurimit të brendshëm të cilësisë duke respektuar kornizat etike dhe ligjore në fuqi, angazhon në mënyrë aktive stafin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri” me profile ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Western Balkan University”.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Ngritja e klubeve studentore në WBU.
2. Organizimi rregullisht i leksioneve të hapura, workshop-eve, trajnimeve etj.
3. Reduktimi i tarifës së shkollimit prej 50%, të studentëve master që janë të punësuar në një nga institucionet partnere.
4. Ndërtimi i një pakete instrumentash për vlerësimin gjithëpërfshirës të Institucionit.
5. Pjesëmarrje aktive të studentëve të programit në praktikën profesionale klinike duke promovuar integrim sa më të shpejtë në tregun e punës.
6. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në NJSBC.
7. Mundësia e aksesimit falas të studentëve në baza të dhënash të rëndësishme mjekësore si Research4Life dhe JSTOR konsiderohet nga GVJ si shembull i praktikës së mirë.

Pika të dobta

1. Mungesa e infermierëve me tituj shkencor dhe grada akademike (**I2, Kriteri 1, II7, Kriteri 1, III1, Kriteri 4**).
2. Mungesa e Rregullores së Njësise Bazë është një pikë e dobët e Institucionit (**I2, Kriteri 3**).
3. Mungesa e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve për studime (**I3, Kriteri 3**).
4. Angazhim i stafit akademik me nivel të njëjtë kualifikimi me ata të programit të studimit (**IV1, Kriteri 1**).

Rekomandime

1. Rritja e numërit të infermierëve me tituj shkencor dhe grada akademike.
2. GVJ sugjeron që Njësia Bazë të hartoj rregulloren e vet.
3. Rritja e numërit të mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve.
4. Gjetjen e mekanizmave efektiv për të angazhuar në programin e studimit staf akademik me grada dhe tituj dhe jo me nivel të njëjtë kualifikimi.



5. GVJ konsideron si të rëndësishme përgatitjen e analizave të vazhdueshme me qëllim përmirësimin e programit të studimit.
6. GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe është e nevojshme që të rriten.
7. GVJ konsideron të rëndësishme që të korrigohet plani mësimor pasi në gjykimin e GVJ-së orët laboratorike janë të pakta dhe gjitha lëndët kanë të njejtin numër kreditesh.
8. Rritja e mbështetjes financiare për stafin akademik për publikime në revista prestigjioze;
9. Hartimi i një udhëzuesi për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Nursing" with profiles provided by the Higher Education Institution "Western Balkan University".

Strengths and affirmations

1. Establishment of students' club at WBU;
2. Regular organization of open lectures, workshops, trainings, etc.;
3. Reduction of the tuition fee by 50%, for master's students who are employed in one of the partner institutions;
4. Development of a package of instruments for the comprehensive assessment of the Institution.
5. Active participation of program students in professional clinical practice, promoting integration as quickly as possible into the labor market;
6. Inclusion of external experts at the Quality Assurance Unit;
7. The possibility of free student access to important medical databases such as Research4Life and JSTOR is considered by EET as a good practice.

Weaknesses

1. Lack of nurses with scientific titles and academic degrees (**I2, Criterion 1, II7, Criterion 1, III1, Criterion 4**).
2. The lack of Basic Unit Regulation is a weak point of the Institution (**I2, Criterion 3**).
3. Lack of mobility of academic staff and students (**I3, Criterion 3**).
4. Engagement of academic staff with the same qualification level as those of the study program (**IV1, Criterion 1**).

Recommendation

1. Increasing the number of nurses with academic degrees and scientific titles;
2. EET suggests that the Department draw up its own regulation;
3. Increasing the number of mobility for academic staff and students;
4. Finding effective mechanisms to engage academic staff with degrees and titles in the study program and not with the same qualification level;
5. EEC considers as important the preparation of continuous analyzes in order to improve the study program;
6. EEC notes that laboratory hours are few and it is necessary to increase them;
7. EEC considers it important to correct the curriculum since the labs hours are not sufficient and all subjects have the same number of credits;
8. Increasing financial support for academic staff for publications in prestigious journals;
9. Drafting a guide for the use of innovative teaching methods.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X